



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

LEGJISLATURA IX - SEANCA E DITËS SË HËNË, 3 DHJETOR 2018, TIRANË

PROCESVERBAL

SEANCËN E DREJTON
KRYETARI I KUVENDIT
GRAMOZ RUÇI

(Opozita nuk është e pranishme në këtë seance plenare.)

(Seanca filloi në orën 10:00)

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare të datës 15.11.2018 *(neni 44 i Rregullores)*

2. Njoftimi i projektligjeve të depozituara në Kuvend *(neni 44, pika 3, i Rregullores)*

3. Projektligji “Për një ndryshim në ligjin nr.102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar” *(nenet 73-77 të Rregullores, votim me shumicë të thjeshtë)*

Pyetje

Shprehet Komisioni përgjegjës për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin.

Diskutime

(Shprehen grupet parlamentare.)

Koha e votimit (në parim, nen për nen dhe në tërësi)

4. Projektligji “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në marrëveshjen e Lisbonës për

mbrojtjen e emërtimeve të origjinës dhe regjistrimin e tyre ndërkombëtar” *(nenet 73-77 të Rregullores, votim me shumicë absolute)*

Pyetje

Shprehet Komisioni përgjegjës për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin.

Shprehet për dhënie mendimi Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

Shprehet për dhënie mendimi Komisioni për Politikën e Jashtme.

Diskutime

(Shprehen grupet parlamentare.)

Koha e votimit (në parim, nen për nen dhe në tërësi)

5. Projektligji “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në amendamentin e Kigalit të protokollit të Montrealit “Për substancat që hollojnë shtresën e ozonit” *(nenet 73-77 të Rregullores, votim me shumicë absolute)*

Pyetje

Shprehet Komisioni përgjegjës për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin.

Shprehet për dhënie mendimi Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

Shprehet për dhënie mendimi Komisioni për Politikën e Jashtme.

Diskutime

(Shprehen grupet parlamentare.)

Koha e votimit (në parim, nen për nen dhe në tërësi)

6. Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë dhe Komisionit Europian për programin e veprimit të bashkëpunimit ndërkufitar IPA II, ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë - Republika e Shqipërisë, 2014-2020, alokimet e vitit 2017” *(nenet 73-77 të Rregullores, votim me shumicë absolute)*

Pyetje

Shprehet Komisioni përgjegjës për Ekonominë dhe Financat.

Shprehet për dhënie mendimi Komisioni për Integrimin Europian.

Shprehet për dhënie mendimi Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

Shprehet për dhënie mendimi Komisioni për Politikën e Jashtme.

Shprehet për dhënie mendimi Komisioni për Sigurinë Kombëtare.

Diskutime

(Shprehen grupet parlamentare.)

Koha e votimit (në parim, nen për nen dhe në tërësi)

7. Projektligji “Për një ndryshim në ligjin nr.9981, datë 08.09.2008 “Për miratimin e niveleve të tarifës doganore”, i ndryshuar” *(nenet 73-74 dhe 82 të Rregullores, votim me shumicë të thjeshtë)*

Shprehet Komisioni përgjegjës për Ekonominë dhe Financat.

Koha e votimit (nen për nen dhe në tërësi)

8. Projektligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9975, datë 28.07.2008 “Për taksat kombëtare”, i ndryshuar” *(nenet 73-74 dhe 82 të Rregullores, votim me shumicë të thjeshtë)*

Shprehet Komisioni përgjegjës për Ekonominë dhe Financat.

Koha e votimit (nen për nen dhe në tërësi)

9. Projektligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar” *(nenet*

73-74 dhe 82 të Rregullores, votim me shumicë të thjeshtë)

Shprehet Komisioni përgjegjës për Ekonominë dhe Financat.

Koha e votimit (nen për nen/në tërësi)

10. Projektligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar” *(nenet 73-74 dhe 82 të Rregullores, votim me shumicë të thjeshtë)*

Shprehet Komisioni përgjegjës për Ekonominë dhe Financat.

Koha e votimit (nen për nen dhe në tërësi)

11. Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.92/2014, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar” *(nenet 73-74 dhe 82 të Rregullores, votim me shumicë të thjeshtë)*

Shprehet Komisioni përgjegjës për Ekonominë dhe Financat.

Koha e votimit (nen për nen dhe në tërësi)

12. Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar” *(nenet 73-74 dhe 82 të Rregullores, votim me shumicë të thjeshtë)*

Shprehet Komisioni përgjegjës për Ekonominë dhe Financat.

Koha e votimit (nen për nen dhe në tërësi)

13. Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 61/2012, “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar” *(nenet 73-74 dhe 82 të Rregullores, votim me shumicë të thjeshtë)*

Shprehet Komisioni përgjegjës për Ekonominë dhe Financat.

Koha e votimit (nen për nen dhe në tërësi)

14. Projektligji “Për buxhetin e vitit 2019” *(nenet 73-74 dhe 82 të Rregullores, votim me shumicë të thjeshtë)*

Shprehet Komisioni përgjegjës për Ekonominë dhe Financat.

Koha e votimit (nen për nen/në tërësi)

15. Projektvendimi “Për emërimin e një anëtarit të Bordit të Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë” *(neni 111 i Rregullores, votim me shumicë të thjeshtë)*

Shprehet Komisioni përgjegjës për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin.

(Shprehen grupet parlamentare.)

Koha e votimit

16. Të bartura për votim:

- Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (neni 81/2 i Kushtetutës dhe nenet 73-77 i Rregullores, votim me shumicë prej 3/5-ve të të gjithë anëtarëve të Kuvendit)

- Projektligji “Për një ndryshim dhe shtesë në ligjin nr. 8378, datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar” (neni 81/2 i Kushtetutës dhe nenet 73-77 të Rregullores, votim me shumicë prej 3/5-ve të të gjithë anëtarëve të Kuvendit)

17. Diskutime për çështje jashtë rendit të ditës (neni 45 i Rregullores)

Koha e diskutimeve deri në 60 minuta

(Pasi lexon rendin e ditës)

Gramoz Ruçi - Për paketën fiskale dhe projektbuxhetin diskutimi në parim është bërë, ndërsa sot do ta diskutojmë nën për nen.

Para se të fillojmë me projektligjin e parë, ju njoftoj se procesverbali i radhës së kaluar është duke u zbardhur, meqenëse seanca ka zgjatur shumë dhe do të miratohet në seancën e ardhshme së bashku me procesverbalin e ditës së sotme.

Ju njoftoj se nga Këshilli i Ministrave është depozituar projektligji “Për vetëqeverisjen vendore”.

Fillojmë me projektligjin e parë “Për një ndryshim në ligjin nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar”.

Fjalën e ka zoti Bujar Çela.

Bujar Çela – Të nderuar kolegë,

Të nderuar qytetarë,

Të gjithë ju që e keni vëmendjen te kjo seancë parlamentare, ku sot do të kalojmë ligjin numër një, atë të buxhetit për vitin 2019, në projektligjin “Për një ndryshim në ligjin nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar”, që është një ndryshim fare i thjeshtë nga ana teknike, ka një ndërhyrje të qeverisë për të lehtësuar të gjitha subjektet, të cilat duan t’i përmirësojnë dhe të kenë lehtësira në aplikime dhe mundësinë e ushtrimit të këtij aktiviteti.

Ky ndryshim konsiston në atë që edhe si në të gjitha licencat e tjera teknike, që i përfitojnë specialistët, inxhinierët teknikë dhe pas tyre i përfitojnë firmat dhe ata që duan të investojnë në këtë sektor kaq të rëndësishëm të ekonomisë.

Unë mendoj se ky është një hap shumë i rëndësishëm lehtësues, edhe në kuadrin e përdorimit të të gjitha lëndëve djegëse, ku gazi është një prej tyre dhe që konsiderohet me mjaft leverdi ekonomike.

Dua t’ju them dy fjalë për buxhetin, për paketën fiskale, si dhe për votimin nën për nen. Në seancën e shkuar ne votuam në parim buxhetin, në të cilin mëshirohen qartë premtimet e dhëna në fushatë elektorale në lidhje me akcizat, tarifatat, taksat, ku çdo ditë kjo qeveri po bën të mundur uljen e tyre.

Ne kemi hequr detyrimet për inputet bujqësore, një premtim i bërë politikisht, i cili është mbajtur dhe që do të reflektohet në buxhetin e këtij viti.

Gjithashtu, dua të them dy fjalë edhe jashtë çështjeve që kemi diskutuar gjatë këtyre seancave, që një vëmendje e madhe i duhet kushtuar çështjes së pronës, titujve të pronësisë, si dhe investimeve më të mëdha në bujqësi. Një vëmendje e madhe u duhet kushtuar pagave dhe pensioneve për pensionistët, si dhe përmirësimit të rrjetit të rëndësishëm rrugor, i cili vende-vende ka prapambetje të theksuara. Problemet e rrugëve janë tejet të rëndësishme. Ne nuk duhet të mbetemi si dikur. Çfarë kërkon qytetari ynë? Rrugë, ujë dhe drita. Prandaj, ne duhet të ndërhyjmë edhe më thellë për t'ua përmirësuar jetën këtyre njerëzve, duke vërtetuar se çdo ditë do të jemi me ta dhe për ta.

Faleminderit!

Gramoz Ruçi – Faleminderit, zoti Çela!

Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste, fjalën e ka zonja Pirro.

Tatjana Pirro – I nderuar zoti Kryetar

Të nderuar kolegë,

Marrëveshja e Lisbonës që propozohet për aderim nëpërmjet këtij projektligji mundëson mbrojtjen ndërkombëtare të emërtimeve të origjinës në vendet anëtare të saj, përmes një regjistrimi të vetëm në Zyrën Ndërkombëtare të Organizatës Botërore të Pronësisë Intelektuale në Gjenevë. Kjo marrëveshje është hartuar në përgjigje të nevojës për një sistem ndërkombëtar që do të lehtësonte mbrojtjen e një kategorie të veçantë të treguesve gjeografikë, siç janë emërtimet e origjinës në vendet e tjera, përveç vendit të origjinës, e ngjashme kjo me sistemin e Madridit për mbrojtjen ndërkombëtare të markave.

Nënshkrimi i kësaj marrëveshjeje ndërkombëtare do të ishte më i favorshëm për mbajtjet e të drejtave mbi emërtimet e origjinës, pasi me anë të një aplikimi të vetëm do të mund të shkurtohet kohë dhe kosto për mbrojtje për 28 shtetet anëtare, përfshirë edhe fqinjët tanë si Greqia, Maqedonia, Mal i Zi dhe Italia.

Sipas nenit 2 të marrëveshjes, “emërtim origjine” nënkupton emërtimin gjeografik të një vendi, rajoni ose lokaliteti, i cili shërben për të përcaktuar një produkt me origjinë nga këto vende, cilësitë ose karakteristikat e të cilit i atribuohen ekskluzivisht ose në thelb mjedisit gjeografik, duke përfshirë faktorë natyrorë dhe njerëzorë.

Shqipëria është një vend që ka shumë produkte të kësaj natyre, të cilat duhen identifikuar për t'u certifikuar, pasi regjistrimi kombëtar e më tej ai ndërkombëtar ndikojnë në rritjen e vlerës së këtyre produkteve tradicionale, në gjallërimin e zonave rurale, në ruajtjen e biodiversitetit të trashëgimisë kulturore e gastronomike dhe ofrojnë mundësinë e njohjes në tregjet të huaja të produkteve karakteristike shqiptare. Regjistrimi ndërkombëtar i emërtimeve të origjinës bëhet nga Zyra Ndërkombëtare e Pronësisë Intelektuale në Gjenevë me kërkesë të autoritetit kompetent të shtetit kontraktues. Kjo zyrë mban regjistrimin ndërkombëtar të emërtimeve të origjinës dhe njofton formalisht shtetet e tjera kontraktuese për regjistrimin.

Gjithashtu, zyra i publikon ato në buletin zyrtar të sistemit të Lisbonës. Organi i ngarkuar për zbatimin e kësaj marrëveshjeje është Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale me cilësinë e institucionit përgjegjës për ndërmarrjen e nismave ligjore në fushën e njohjes së administrimit të të drejtave të pronësisë industriale në Shqipëri. Kontributi që Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale duhet të paguajë nëse aderim në marrëveshjen e Lisbonës varet nga një sërë faktorësh, ku konkretisht do të merret parasysh shuma e deficitit të parashikuar gjatë 2-vjeçarit, nëse ka, numri i vendeve anëtare në marrëveshje, klasa e kontributeve të cilës i përket Shqipëria, si dhe mënyra se si vendet anëtare të Unionit të Lisbonës vendosin ta përdorin kontributin.

Të nderuar kolegë,

Duke qenë se aderimi në këtë akt siguron mjetet ligjore, që vendet anëtare të parandalojnë një përdorim të paautorizuar të emërtimeve të origjinës së një vendi, shmanget një praktikë që mashtron konsumatorin në lidhje me origjinën e vërtetë apo natyrën e mallrave, si dhe ndikon në rritjen e vlerës së këtyre produkteve tradicionale shqiptare, ju ftoj ta miratojmë këtë projektligj.

Ju faleminderit!

Gramoz Ruçi – Zonja Tatjana u shpreh për marrëveshjen “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në marrëveshjen e Lisbonës për mbrojtjen e emërtimeve të origjinës dhe regjistrimin e tyre ndërkombëtar” në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste. Këtu mbyllet diskutimi për këtë marrëveshje.

Vazhdojmë me projektligjin “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në amendamentin e Kigalit të protokollit të Montrealit “Për substancat që hollojnë shtresën e ozonit””. Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste, fjalën e ka zoti Baraj.

Besnik Baraj – Askush nuk mund ta mendonte që ai, që u konsiderua si një nga shpikjet më të rëndësishme të njerëzimit, gati 100 vjet më parë, gazi frigoriferik, tani, pas 60 vjetësh të konsiderohet nga shkencëtarët si një nga faktorët që ndikon në hollimin e shtresës së ozonit. Sigurisht, ky është një mësim i madh, i cili lidhet me kufizimet e teknologjisë dhe të shkencës për kohën, por nga ana tjetër është një mësim i madh, dhe ka shumë rëndësi që gjithmonë politika të ketë pranë njerëz sa më të kualifikuar, si dhe një bashkëpunim sa më të ngushtë me rrethet shkencore për të parashikuar problemet e ndryshme me të cilat ndeshet njerëzimi.

Sidoqoftë, në radhë të parë, në nivel global janë marrë masa, ku Shqipëria është bërë pjesë e këtyre masave, duke ratifikuar konventa, protokolle, amendime të ndryshme dhe një nga këto është pikërisht edhe amendimi i Kigalit, i cili parashikon plotësimin e kuadrit ligjor për masat që duhet të ndërmerren për kufizimin e këtyre lëndëve. Shqipëria ka vite që bën pjesë në këtë dhe ka marrë një sërë masash, ju kujtoj ato që janë marrë në fillim të viteve 2000, 2003, 2004. Përgjithësisht, ishte gazi frigoriferik, i cili përbëhej kryesisht nga hidrokarburet që përmbanin fluor në kompozimet e tyre, i cili u zëvendësua me gazin që nuk e kishte këtë efekt serrë.

Këtu, krahas adoptimit të kuadrit ligjor, një rëndësi shumë të madhe merr kontrolli, monitorimi dhe realizimi në terren i përvojave për shkatërrimin e këtyre lëndëve, sepse, në qoftë se ato pasi zëvendësohen, përsëri emetohen në natyrë, pa dyshim kanë efekt sikur ligji të mos ekzistojë. Shqipëria, si gjithmonë, siç ndodh rëndom shpeshherë (është edhe një nga vërejtjet që bëjnë organizmat ndërkombëtarë), kur vjen puna për zbatimin e legjislacionit ka probleme, sepse ato lidhen me struktura të caktuara, me burime financiare dhe në këtë kuadër do t’ju thosha që Ministria e Mjedisit dhe ministrinë që merren me monitorimin e këtij sektori të bëjnë kujdes për asgjësimin e këtyre lëndëve, që ende

mund të jenë stok në frigoriferë të ndryshëm, dhe të ndalojnë importimin e atyre pajisjeve që përdorin këtë lloj gazi, të cilat shpeshherë bëhen pjesë e moszbatimit të ligjeve.

Unë ftoj të gjithë kolegët ta miratojmë këtë projektligj!

Faleminderit!

Gramoz Ruçi – Faleminderit, zoti Baraj!

Kalojmë te projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë dhe Komisionit Europian për programin e bashkëpunimit ndërkufitar IPA II, ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë, Republika e Shqipërisë, 2014-2020, alokimet për vitin 2017”

Fjalën e ka zonja Spiropali.

Elisa Spiropali - I nderuar Kryetar,

Të nderuar kolegë,

Të dashur qytetarë,

Kjo marrëveshje do të mundësojë zbatimin e përbashkët të projekteve për të ardhmen ndërmjet Maqedonisë dhe Shqipërisë sipas prioriteteve të përcaktuara në programin e veprimit të bashkëpunimit ndërkufitar IPA II, të financuar nga Bashkimi Europian. Përfitues të këtij projekti në Shqipëri janë zona e Dibrës, që është dhe zonë kufitare, konkretisht: Bulqiza, Burreli dhe Dibra, zona e Elbasanit me qytetet: Cërrik, Elbasan, Gramsh, Librazhd, dhe Peqin, zona e Korçës me qytetet: Devoll, Korçë, Kolonjë dhe Pogradec.

Ky program bashkëpunimi ndërmjet Maqedonisë dhe Shqipërisë ka për qëllim kryesor të kontribuojë në zhvillimin socio-ekonomik të zonave ndërkufitare dhe të rrisë bashkëpunimin ndërmjet dy vendeve përmes ndërhyrjeve të përbashkëta.

Duke marrë parasysh që Shqipëria, por edhe vende të tjera të rajonit e kanë prioritet bashkëpunimin përmes Bashkimit Europian, si edhe qëllimet tona të përbashkëta në rrugën e integritit, nëse me shtetet e tjera të rajonit Shqipëria e ka, le të themi, dashamirësinë për të kontribuar, me Kosovën e ka domosdoshmëri. Në këto ditë festash këndeje dhe andej kufirit valon flamuri kombëtar. Shqiptarët kudo festojnë me krenari 28 Nëntorin, këtë datë që shënon themelimin e shtetit tonë.

Në themel të krenarisë së kësaj date qëndron simboli i flamurit, shqiponja me dy

krerë në fushë të zezë. Ky simbol na bashkon kudo dhe gjithmonë në kohë dhe në të gjitha hapësirat tona. Takimi i fundit i qeverisë së Shqipërisë dhe qeverisë së Kosovës në Pejë dhe vizioni i shpalosur nga të dy kryeministrat për përafrim dhe bashkim të shqiptarëve ngjall entuziazëm kudo ndër shqiptarë, të cilët ndoshta jo të gjithë e kuptojnë, por e ndiejnë plotësisht domosdoshmërinë e kësaj platforme bashkimi.

Ndërkohë, sigurisht kjo ka ngjallur mërinë e faktorëve konfliktualë në rajon të frikësuar nga ideja e bashkimit dhe forcimit të shqiptarëve, por ka ngjallur edhe mërinë e zezëkëve dhe grindavecëve tanë të kudondodhur këndeje dhe andej kufirit. Nuk ka problem, me kakarisjet e ngrehalucëve jemi mësuar.

Sa i takon opozitës sonë, e cila e ka zbrazur të gjithë arsenalin e mjerë të banalitetit kundër iniciatorit dhe mbështetësit më të fortë të kësaj platforme, Kryeministrit, është për t'u kuptuar, madje për t'u mëshiruar egërsia e paqedershme e sulmeve të një opozite të katandisur në këtë derexhe, që nuk i buron nga kundërshtimi i bashkimit, por nga tmerri i vetëshkatërrimit për shkak të mungesës së çdo vizioni për të ardhmen.

Po na dërdëllisin se bashkimi i shqiptarëve është çështje folklorike, çështje emocionale dhe se ky koncept i përket së shkuarës. Pikërisht këtu ngatërrohen dhe gabohen kozmopolitët tanë mesjetarë. Bashkimi i shqiptarëve nuk i takon së kaluarës, por i takon së ardhmes. Ky bashkim nuk është vetëm çështje emocionale, por është edhe çështje racionale dhe çështje e interesit tonë kombëtar. Të dyja shtetet shqiptare në Ballkan jetojnë në një kontradiktë nga ku buron mungesa jonë e zhvillimit. Ne kemi dy shtete të dobëta, edhe pse kemi një komb të fortë, i cili e ka dëshmuar historikisht fuqinë e tij të jashtëzakonshme mbijetuese. Një komb i fortë ka nevojë për një shtet të fortë. Ne duhet të ndërtojmë shtet për kombin dhe jo kombe të ndryshme për dy shtetet tona. A keni parë ndonjë komb të bashkohet në struktura hipernacionale ose supernacionale? Vetëm shtetet bashkohen në struktura, në këtë rast në strukturën e BE-së. Kombet bashkohen duke thyer barrierat mes vetes. Bashkimi European nuk është një strukturë e sheshtë, por një katedrale hierarkike. Ne dëshirojmë me të gjitha energjitë tona që kombi ynë të jetë pjesë e familjes europiane dhe kemi

bërë çdo përpjekje që të jemi pjesë e Bashkimit European.

Sa më të fuqishëm të jemi para se të hyjnë aq më mirë do t'i kemi punët kur të jemi brenda.

Para dy ditësh morëm lajmin e mirë se Parlamenti European votoi me shumicë votash raportin e vitit 2018 për Shqipërinë, i cili mbështet plotësisht rekomandimin e Komisionit European që negociatat me Shqipërinë duhet të hapen si njohje e përpjekjeve reformuese të bëra nga Shqipëria, por nuk mund të rri pa shprehur zhgënjimin që Kosovës iu premtua, por nuk iu dha liberalizimi i vizave. Është e papranueshme dhe e pakuptueshme që shqiptarët e Kosovës vazhdojnë të mbahen peng i dinamikave të brendshme të vendeve të BE-së, ndërkohë që Serbia jo vetëm lëviz pa viza, por ka hapur negociatat përpara Shqipërisë pa e njohur fare Kosovën dhe sovranitetin e saj.

Kosova ka bërë një rrugë të jashtëzakonshme në ngritjen e shtetit, respektimin e të drejtave të minoriteteve dhe përpjekje të jashtëzakonshme për dialog të hapur me Serbinë, ndërkohë Serbia nuk e njeh Kosovën të ndarë nga ajo dhe bën çmos për minimin e ardhmërisë së saj.

Serbia pengon Kosovën në të gjitha përpjekjet për njohje institucionale, pengon çdo lloj malli të hyjë nga Kosova në Serbi, por bërë kur Kosova vendos reciprocitet, sepse dëshiron që Kosova të vazhdojë të jetë një koloni tregtare e Serbisë me emrin Kosovë-Metohi.

Kur shqiptarët do të fillojnë të bashkohen, aspiratat hegjemone dhe delirante të çdo force radikale në vendet fqinje do të zmbrapsen. Ne nuk do të bëhemi bashkë që të sulmojmë, por do të bëhemi bashkë që të mbrohemi dhe të zhvillohemi.

Ne jemi kombi më besnik në Ballkan ndaj Bashkimit European dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Kurrë nuk kemi flirtuar me faktorë të tjerë gjeopolitikë dhe nuk kemi treguar kurrë asnjë dyfytirësi në raport me fqinjët, përkundrazi, kemi dëshmuar se jemi faktori më i sigurt në rajon dhe një partner për t'u besuar, por kombit shqiptar i është bërë një padrejtësi e madhe historike: ndarja. Ne duhet të kryejmë korrigjimin e kësaj padrejtësie, nuk mundet që faktorët të shpallen viktima dhe viktimat të durojnë të mbeten të tilla përgjithmonë. Kosovës nuk mund t'i refuzohet padrejtësisht liberalizimi

i vizave dhe Serbia të vazhdojë e patrazuar negociimin e kapitujve pa njohjen e sovranitetit të Kosovës. Është jashtëzakonisht motivuese ajo që dy kryeministra shpallën për krijimin dhe financimin e një përpjekjeje të përbashkët, hartimin e një dokumenti analitik dhe strategjik si rruga e bashkimit të shqiptarëve në horizontin e vitit 2025. E ardhmja i përket bashkimit të shqiptarëve.

Po ashtu një grup masash të nënshkuara nga të dyja qeveritë janë hapa të mëdhenj përpara, zero barriera tarifore dhe jotarifore, transit i përbashkët doganor në Durrës, i cili duhet të shkojë patjetër drejt bashkimit doganor, një doganë e përbashkët në Morinë. Në Muriqan e kemi doganën e përbashkët me Malin e Zi. Kush janë ata që mund të na thonë se nuk mund ta kemi me Kosovën? Heqja e të gjithë dokumentacionit absurd për eksport import me dy palë letra të Autoritetit të Ushqimit, heqja e romingut midis dy vendeve, njohja e patentave e të tjera masa të rëndësishme duhet të kthehen në shembuj si mund të ecim përpara në terrenin e bashkimit ekonomik, si, për shembull, lidhja energjetike Kosovë-Shqipëri është kyçe për zhvillimin ekonomik, unioni doganor, fiskal dhe monetar, një kombëtare në çdo sport dhe një akademi e shkencave dhe arteve për të dyja vendet. Ne ende nuk kemi një akademi shkencash këtu dhe në Kosovë, e cila të hartojë një platformë për shqiptarët ose të paktën të synojë të nxjerrë në pah identitetin tonë. Çdo vend që është serioz dhe çdo vend që dëshiron të zhvillohet duhet ta ketë të qartë të kaluarën e vet.

Ne duhet ta kuptojmë se bashkimi i shqiptarëve është i domosdoshëm për të siguruar zhvillim ekonomik. Shqiptarët nuk janë të varfër, sepse janë të paaftë, por sepse janë të ndarë. Shqipëria ka det, ka male, ka ujëra, ka pasuri nëntokësore, Kosova po ashtu ka fusha, qymyr dhe pasuri të tjera nëntokësore. Pasuritë tona këtej dhe andej mund të kombinohen dhe mund të jenë komplementare për të pasur një zhvillim ekonomik të jashtëzakonshëm.

Bashkimi i shqiptarëve do të na shpëtojë edhe nga kompleksi i kombit të vogël. Ne jemi shtete të vogla, por jemi komb i madh. E keni parë se edhe në shoqërinë tonë kemi prirje për krahinorizëm, provincializëm, lokalizëm, si refuzues të demokracisë, armiq, në fakt, të demokracisë. Të gjitha janë pasoja të faktit që

funksionojmë brenda mentalitetit të ndarjes. Me bashkimin e faktorit shqiptar ne sigurojmë një bazë të gjerë legjitimiteti, masën e nevojshme demokratike për një demokraci më cilësore. Ne nuk do të jemi më një vend me aq e kaq banorë, (Shqipëria me 3 milionë thonë disa, ose me 2 milionë e gjysmë thonë disa të tjerë, Kosova me 2 milionë ose me 1 milion e gjysmë), por do të jemi një vend relativisht i madh dhe i rëndësishëm në rajon. Nuk do të jemi më një vend me gegë dhe toskë, me veri dhe jug, me shqiptarë të kësaj krahine dhe të asaj krahine, por shqiptarë të bashkuar nga vizioni për emancipim dhe zhvillim kombëtar.

Takimi i qeverive, ku u shpalos ky vizion besoj se është guri i themelit për të ndërtuar së bashku këtë vizion të përbashkët. Opozita jonë është fatkeqe edhe kur diskutohen çështjet e Shqipërisë në Bruksel, edhe kur parlamenti voton, por nuk është prezente, është po aq fatkeqe edhe kur merr gurët dhe godet çdo iniciativë, e cila i kalon interesat e saj të momentit, që është lufta politike dhe lufta për pushtet.

Ne kemi një vizion dhe duam ta ndajmë me të gjithë shqiptarët. Unë inkurajoj qeverinë që të vazhdojë në këtë drejtim për të bërë të mundur atë që qeveri të mëparshme nuk e kanë bërë, të cilat kanë ngritur flamurin folklorik, por, kur ka ardhur puna, kanë minuar përpjekjet e vërteta për bashkimin dhe formimin e faktorit shqiptar.

Faleminderit!

Gramoz Ruçi – Fjalën e ka ministri për Europën dhe Punët e Jashtme, zoti Bushati.

Ditmir Bushati - Zoti Kryetar,

Kolegë deputetë, ne sot shqyrtojmë marrëveshjen me ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe Komisionit Europian për programin e veprimit në kuadër të bashkëpunimit ndërkufitar IPA II ose siç quhet ndryshe, programet e Bashkimit Europian për projektet ndërkufitare.

Para pak javësh ne kemi miratuar, gjithashtu, marrëveshjen me Kosovën dhe Bashkimin Europian, po kështu marrëveshjen me Malin e Zi dhe Bashkimin Europian. Janë tri vende me të cilët kemi një bashkëpunim në nivel qeveritar, i cili reflektohet edhe në kuadër të mbledhjeve të përbashkëta të dy qeverive me secilën prej këtyre tri vendeve, ku pjesë e diskutimit është nevoja për racionalizim dhe

fokus më të madh te projektet që u shërbejnë komuniteteve që jetojnë në anët e ndryshme të kufirit.

Siç e tha edhe zonja Spiropali, Shqipëria në këtë kontekst ka një specifikë të veçantë, sepse përgjithësisht rrethohet nga popullsi shqiptare edhe në linjën kufitare. Natyrisht që ne i japim një rëndësi të posaçme bashkëpunimit ndërkufitar edhe në kuadër të procesit të integritetit evropian dhe fondeve që vendosin në dispozicion taksapaguesit evropianë, siç është fondi i sotëm rreth 1,2 milionë euro, sepse në themel qëndron puna me komunitetet shqiptare kudo ku ata jetojnë.

Me qeverinë e Maqedonisë kemi bërë, gjithashtu, vitin e kaluar, për herë të parë, mbledhjen e përbashkët dhe kemi rënë dakord për të intensifikuar bashkëpunimin ndërkufitar edhe në përputhje me prioritetet që kemi përcaktuar së bashku me BE-në. Nga ky fond dhe nga kjo marrëveshje, që po e miratojmë sot, për sa na takon, përfitojnë qarku i Durrësit, qarku i Elbasanit dhe qarku i Korçës. Më vjen mirë që deputetët që janë zgjedhur në këto qarqe, kanë qenë promotorët kryesorë për të mbështetur këtë marrëveshje që vjen sot në Kuvend.

Gjithashtu, fokusi i kësaj thirrjeje dhe kësaj marrëveshjeje, përgjithësisht, ka qenë i lidhur me fushën e teknologjisë së informacionit, turizmin, zhvillimin e turizmit ndërkufitar në liqenin e Ohrit, me stimulimin e sipërmarrjeve sociale në zonat ndërkufitare, me ruajtjen e trashëgimisë kulturore, dhe, natyrisht, në fokus kanë qenë edhe projektet në fushën e mjedisit.

Të njëjtin mesazh, mbështetje dhe vëmendje kemi dhënë edhe për sa u përket të drejtave të shqiptarëve që jetojnë në Maqedoni, sikundër kemi mbështetur të gjitha zhvillimet demokratike atje, marrëveshjen e Prespës, e cila, natyrisht, hapi rrugën e zgjidhjes së një konflikti shumëvjeçar me Greqinë, por edhe perspektivës së qartë euroatlantike.

Me Maqedoninë po punojmë, gjithashtu, edhe në kuadër të procesit të përgatitjes për fillimin e bisedimeve për anëtarësim. Duke qenë se të dyja vendet tona janë të ulura në tryezë për procesin parapërgatitor, presim që në vitin 2019 të fillojmë zyrtarisht bisedimet dhe të kemi konferencën e parë ndërqeveritare bazuar në vendimmarrjen e vendeve anëtare në qershorin e këtij viti.

E njëjta gjë mund të thuhet edhe në lidhje me programet e tjera që kemi, qoftë me Kosovën dhe Malin e Zi. Javën e kaluar pata mundësinë të isha në Plavë e Guci për festat kombëtare dhe, në emër të qeverisë shqiptare, inaugurua së bashku Zyrën e Këshillit Kombëtar, që trupëzon gjithë faktorin politik shqiptar.

Të njëjtin mesazh bashkëpunimi dhamë edhe në takimin me kryetarin e Bashkisë së Malësisë së Madhe, edhe në takimet me përfaqësuesit e autoriteteve vendore të Plavës dhe Gucisë për nevojën që këto programe dhe këto mundësi që ofron Bashkimi Evropian të prodhojnë një realitet të prekshëm për banorët që jetojnë në të dyja anët e kufirit dhe në të njëjtën kohë të bashkojnë mendjet dhe zemrat e shqiptarëve, duke qenë se flasim të njëjtën gjuhë, jemi i njëjti komb, ruajmë dhe duhet të promovojmë të njëjtat tradita.

Kjo javë që sapo u mbyll, gjithashtu, shënoi një zhvillim pozitiv në mjediset e Parlamentit Evropian, ku Shqipërisë iu dha një mbështetje e gjerë për të nisur procesin e bisedimeve për anëtarësim vitin e ardhshëm. Ne u jemi mirënjohës këtij parlamenti, deputetëve, reporterëve për Shqipërinë, grupimeve kryesore politike, të cilët e kanë pasur si kompas orientues procesin e reformave shtetndërtuese dhe shtetkonsoliduese në Shqipëri, por edhe në vendet e tjera të rajonit. Jemi mirënjohës, gjithashtu, që në ditët tona më të vështira, në kuptimin politik të fjalës, interesi kryesor qoftë për grupimet kryesore në Parlamentin Evropian dhe institucionet e BE-së, ka qenë fati i Shqipërisë dhe jo fati i aktorëve të ndryshëm politikë. Na erdhi keq të konstatojmë se, si rrallëherë, opozita heshti për miratimin e kësaj rezolute të rëndësishme në Parlamentin Evropian, që jo vetëm bie katërcipërisht dakord me gjetjet e Komisionit Evropian, me rekomandimin për fillimin e bisedimeve për anëtarësim të Shqipërisë, por në të njëjtën kohë raporti i miratuar në Parlamentin Evropian thekson qartë kursin e reformave të mëdha që ka ndërmarrë Shqipëria, kryesisht në fushën e sundimit të së drejtës në ekonomi, rolin dinamik dhe konstruktiv në rajon. Sot nuk ka rëndësi sa i madh apo i vogël je, pesha e zhvillimeve në rajon dhe kudo në botë përcaktohet nga mënyra e mençur e të bërit politikë. Shqipëria dhe shqiptarët gjatë gjithë këtyre viteve janë renditur

në krah të familjes euroatlantike. Edhe në këto zhvillime, në të cilat rajoni ynë është përfshirë, Shqipëria dhe shqiptarët jam i bindur që do të orientohen për nga e mira.

Faleminderit!

Gramoz Ruçi - Faleminderit, zoti Ministër!

Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste, fjalën e ka zoti Xhelilaj.

Roland Xhelilaj - Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar kolegë,

Projektligji "Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë dhe Komisionit Europian për programin e veprimit të bashkëpunimit ndërkufitar IPA II, me ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë - Republika e Shqipërisë, 2014-2020, alokimet e vitit 2017" është propozuar nga Këshilli i Ministrave.

Marrëveshja është nënshkruar në muajin janar nga Komisioni Europian, si dhe nga Shqipëria dhe Maqedonia në muajin gusht të këtij viti dhe parashikon financimin për programin e veprimit të bashkëpunimit ndërkufitar Shqipëri-Maqedoni për alokimet e vitit 2017. Ky financim do të realizohet nga granti i Bashkimit Europian ndërmjet instrumentit IPA II, prej rreth 1,2 milionë eurosh për të dyja vendet. Duke përfshirë edhe bashkëfinancimin kombëtar të këtyre dy vendeve, buxheti i përgjithshëm i programit për vitin 2017 është 1,4 milionë euro. Përfitimi i të dyja vendeve do të jetë i barabartë, ndaj pritet që vendi ynë të përfitojë një grant prej 600 mijë eurosh. Për çdo projekt që do të financohet nga kjo marrëveshje, përveç projekteve të asistencës teknike, financimi do të sigurohet në masën 85% nga granti i Bashkimit Europian dhe 15 % nga bashkëfinancimi i dy vendeve tona.

Programi që parashikohet të financohet me këtë marrëveshje është pjesë e programit të bashkëpunimit ndërkufitar Shqipëri-Maqedoni 2014-2020 dhe ka një vlerë totale prej 11,9 milionë eurosh. Ai përfshin disa marrëveshje të ratifikuara më parë, ose të parashikuara për t'u ratifikuar në të ardhmen.

Ky program bashkëpunimi me Maqedoninë synon të japë kontribut në zhvillimin social-ekonomik të zonave ndërkufitare, në krahun tonë

përfitojnë qarqet: Dibër, Korçë dhe Elbasan, dhe të rrisë bashkëpunimin ndërmjet dy vendeve, kryesisht me projekte të përbashkëta duke i dhënë përparësi nxitjes së turizmit, kulturës dhe trashëgimisë natyrore; rritjes së konkurrencës, biznesit, tregtisë dhe investimeve; mbrojtjes së mjedisit, nxitjes së përshtatjes dhe lehtësimit ndaj ndryshimeve klimatike, parandalimit dhe menaxhimit të rrezikut.

Projektligji është shumë i rëndësishëm pasi siguron vijimësinë e programit disavjeçar të bashkëpunimit me Maqedoninë. Ai do të ndihmojë në zhvillimin social dhe ekonomik të zonave ndërkufitare si të Shqipërisë edhe të Maqedonisë, siç theksova më sipër, sidomos në turizëm, në zgjerimin e veprimtarisë së biznesit duke i bërë ato konkurrese në rritjen e investimeve, por do të ndikojë pozitivisht edhe në rritjen e punësimit në këto zona.

Duke qenë se shumica e financimit do të detajohet me projekte, është e nevojshme që strukturat ekzekutive të zonave përkatëse të hartojnë dhe të propozojnë projekte cilësore, zbatimimi i të cilave do të çojë patjetër në realizimin me sukses të programit.

Duke u mbështetur për sa më sipër, i propozoj Kuvendit miratimin e projektligjit.

Gramoz Ruçi - Faleminderit!

Këtu përfundojnë diskutimet për projektligjet e vendosura për në seancën e sotme. Lidhur me paketën fiskale dhe projektbuxhetin e vitit 2019, relatorët do të flasin gjatë procesit të votimit. Diskutime për çështje jashtë rendit të ditës nuk ka.

Në orën 12.00 do të zhvillohet procesi i votimit dhe paraqitja e mendimit të relatorëve për projektbuxhetin dhe paketën fiskale.

(Rifillon seanca.)

Gramoz Ruçi – Uluni, kolegë deputetë!

Të futet media brenda.

A jeni gati, zoti Balla?

Atëherë, rifillojmë seancën.

Hapet votimi për prezencën.

Të hiqen kartonët e zotit Ndraxhi, zotit Bici dhe zotit Doshi.

Mbyllet votimi.

Të pranishëm janë 74 deputetë.

Kalojmë në votimin e projektligjit “Për një ndryshim në ligjin nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar”.

Hapet votimi me elektronikë në parim.

Mbyllet votimi.

74 vota pro, asnjë kundër, asnjë abstenim.

Miratohet.

Vazhdojmë me votimin nen për nen me karton, sipas variantit të propozuar, meqenëse komisioni përgjegjës nuk ka bërë vërejtje.

Neni 1. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 2. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi.

Hapet votimi.

Mbyllet votimi.

74 vota pro, asnjë kundër, asnjë abstenim.

Miratohet.

Kalojmë në votimin e projektligjit “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në marrëveshjen e Lisbonës për mbrojtjen e emërtimeve të origjinës dhe regjistrimin e tyre ndërkombëtar”.

Hapet votimi me elektronikë në parim.

Mbyllet votimi.

74 vota pro, asnjë kundër, asnjë abstenim.

Miratohet.

Vazhdojmë me votimin nen për nen me kartonë, sipas variantit të paraqitur nga propozuesi.

Neni 1. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 2. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi.

Hapet votimi me elektronikë në tërësi.

Mbyllet votimi.

75 vota pro, asnjë kundër, asnjë abstenim.

Miratohet.

Kalojmë në projektligjin “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në amendamentin e Kigalit të protokollit të Montrealit “Për substancat që hollojnë shtresën e ozonit””.

Hapet votimi me elektronikë në parim.

Mbyllet votimi.

75 vota pro, asnjë kundër, asnjë abstenim.

Miratohet në parim projektligji.

Vazhdojmë me votimin nen për nen me karton, sipas variantit të paraqitur.

Neni 1. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 2. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi me elektronikë.

Hapet votimi.

Mbyllet votimi.

75 vota pro, asnjë kundër, asnjë abstenim.

Miratohet projektligji në tërësi.

Vazhdojmë me votimin e projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë dhe Komisionit Europian për programin e veprimit të bashkëpunimit ndërkufitar IPA II, ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë - Republika e Shqipërisë, 2014-2020, alokimet e vitit 2017”.

Hapet votimi me elektronikë në parim.

Mbyllet votimi.

75 vota pro, asnjë kundër, asnjë abstenim.

Miratohet në parim.

Kalojmë në votimin nen për nen me kartonë.

Neni 1. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 2. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi.

Hapet votimi me elektronikë.

Mbyllet votimi.

75 vota pro, asnjë kundër, asnjë abstenim.

Miratohet në tërësi projektligji

Vazhdojmë me ligjet e paketës fiskale.

Para se të fillojmë me votimin, dua t’ju them se për buxhetin janë regjistruar 3 deputetë: zoti Angjeli, zonja Gjylameti dhe zoti Bushati.

Taulant Balla – Meqenëse në rendin e ditës është për t’u miratuar projektligji “Për miratimin e niveleve të tarifës doganore”, mendoj që të vazhdojmë me këtë projektligji dhe

më pas të vazhdojmë me radhë, me paketën dhe me buxhetin.

Gramoz Ruçi – Ju lutem, paketa fiskale është sipas radhës që kanë ligjet.

Kush e do fjalën lidhur me paketën fiskale?

Po, zoti Bushati.

Ervin Bushati - Faleminderit, zoti Kryetar!

Në fakt, në paketën fiskale paraqiten një sërë ndryshimesh dhe premtimesh të mbajtura, që kanë të bëjnë kryesisht me bujqësinë, ku për herë të parë përjashtohet TVSH-ja për inputet bujqësore. Pra, kjo është një kërkesë që ka ardhur nga të gjithë fermerët dhe aktorët që merren me bujqësi në Shqipëri. Për herë të parë përjashtohet TVSH-ja për inputet bujqësore për të gjithë fermerët, ku nga 20%, që ka qenë, bëhet zero.

Së dyti, një pikë e rëndësishme është edhe furnizimi me makineri bujqësore, për të cilat TVSH-ja bëhet zero. Kjo ka qenë për të gjitha makineritë që importoheshin, por sot është edhe për makineritë që tregtohen brenda tregut, të cilat përjashtohen nga lista.

Gjithashtu, një kërkesë tjetër, që na është paraqitur nga grupet e interesit dhe nga fermerët është furnizimi i shërbimeve veterinarë, për të cilat, gjithashtu, TVSH-ja bëhet zero. Ndërkohë, norma e kompensimit për prodhuesit bujqësor nga 20%, ulet në 6%.

Gjithashtu, kemi një ndryshim për sa i përket furnizimit dhe shitjes së librave, pasi TVSH-ja nga 20% bëhet 6%.

Një ndryshim tjetër i rëndësishëm lidhet me transportin publik, që ka të bëjë me teknologjinë inovative dhe mbrojtjen e mjedisit, ku për gjithë autobusët elektrikë të transportit publik, pra ata që hiqen nga përdorimi i karburanteve fosile si nafta dhe benzina TVSH-ja ulet në 6% deri në datën 31 dhjetor të vitit 2021 dhe nga data 1 janar 2022 do të ulet në 10%. Pra, për 3 vjet TVSH-ja do të jetë 6% për autobusët, të cilët janë 9 plus 1 vende ose më shumë. Specifikimi që i bëmë ndryshimit në Komisionin e Ekonomisë ishte 9 vende plus 1. Gjithashtu, kemi ndryshimin për dixhitalizimin e medieëve audiovizive, ku shkalla e aplikimit të TVSH-së për furnizimin e shërbimit të reklamave shkon në 6%. Këto janë ndryshimet kryesore të paketës fiskale lidhur me TVSH-në.

Gramoz Ruçi –Faleminderit!

Po, zonja Gjylameti.

Blerina Gjylameti – Paketa fiskale ka edhe disa ndryshime të tjera.

Së pari, ulja e normës së dividendit nga 15% në 8%, së tatimit mbi të ardhurat, në mënyrë që një pjesë e konsiderueshme e bizneseve të kalojnë në paketën e tatimit mbi të ardhurat.

Ndërsa në anën tjetër kemi edhe një ndikim në uljen e tatimit mbi të ardhurat për ngarkesën që kanë 15400 punonjës, të cilët janë në fashën e të ardhurave nga 13 mijë deri në 15 mijë lekë në muaj. Kjo ulje do të ndikojë tek të gjithë ata që kanë këto paga.

Gjithashtu, kemi pasur një ndryshim për sa i përket taksës së ndikimit në infrastrukturë. Ky është një amendim i bërë në Komisionin e Ekonomisë. Për ndërtesat që destinohen për banim në zonat rurale, taksa e ndikimit në infrastrukturë do të zbresë nga 3 në 0%, duke synuar lehtësimin e të gjitha pagesave për të gjithë ata që duan të vazhdojnë të jetojnë në fshatra.

Ndryshim tjetër ka edhe për industrinë përpunuese të kromit. Pra ka një ndryshim në rentën minerare, duke rritur kështu prodhimin e kromit që është i destinuar për eksport. Nga viti 2019 do të ketë një rritje nga 7% në 8% dhe 9% në vitin 2021. Kjo do të ketë ndikim në të gjithë ato zona që merren me industrinë e nxjerrjes së kromit, por edhe të përpunimit të tij.

Faleminderit!

Gramoz Ruçi – Faleminderit, zonja Gjylameti!

Fillojmë me votimin. Para se të kalojmë në nenin 1, kemi të depozituar një amendament nga zoti Braçe, i cili e ka paraqitur 24 orë përpara seancës plenare. Amendamenti konsiston në heqjen e nenit 1 të projektligjit.

Zoti Braçe dëshironi të shprehëni?

Erion Braçe – Për cilin projektligj?

Gramoz Ruçi – Projektligjin për tarifën doganore.

Erion Braçe – I nderuar Kryetar,

Të nderuar kolegë,

Amendamenti konsiston në mosvotimin e nenit 1 të projektligjit për ndryshimin e tarifës doganore për një grup kodesh që i korrespondojnë një malli të caktuar. Argumenti është shumë i qartë, i shkruar edhe në amendamentin e paraqitur. Ky projektligj bie në

kundërshtim me ligjin nr. 9590, datë 27.03.2006 “Për ratifikimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit”, konkretisht me kapitullin 3, nenet 32 dhe 33, pika 1. Në nenin 33 thuhet: “Që nga data e hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshjeje, (bëhet fjalë për Marrëveshjen e Stabilizim – Asociimit), nuk vendosen tarifa të reja për importet dhe eksportet ose tarifa të reja me efekt të njëjtë me to dhe nuk rriten as ato për mallrat që tregtohen mes Komunitetit dhe Shqipërisë”. Pra, bëhet fjalë për Komunitetin Europian.

Gjithashtu, projektligji duhet të mbante në konsideratë edhe detyrimet që ka vendi ynë me Organizatën Botërore të Tregtisë, që edhe për raste të unifikimit të tarifave doganore për kodet tarifore 18/418, tarifa e re të mos jetë me e lartë se 5%. Dua t’ju shpjegoj se tarifa sot është 2% për këto grupe mallrash, pra bëhet fjalë për mallra që vijnë nga vende të Bashkimit Europian, ndërkohë që është propozuar të shkojë në 10%. Pra, kemi dy ndalime të qarta, i pari vjen nga Marrëveshja e Stabilizim - Asociimit me Bashkimin Europian në fuqi dhe ndalimi tjetër vjen nga detyrimet që kemi me Organizatën Botërore të Tregtisë për nivelin e rritjes së tarifave apo unifikimin, e cila në këtë rast shkon 10%, pra rritet me 500%.

Edhe një herë propozoj që të mos miratohet neni 1, sepse bie ndesh me këto dy marrëveshje ku ne jemi palë. Dua t’ju them që as nuk jemi dhe as nuk kemi këllqet e Amerikës, e cila rinegocion nga e para tarifat për mallrat apo tarifat në tregti. Shqipëria në raport me Bashkimin Europian ka vendosur këtë nivel dhe Marrëveshja e Stabilizim - Asociimit dhe Marrëveshja me Organizatën Botërore të Tregtisë përcaktojnë në mënyrë të qartë se nuk mund t’i rrisim këto tarifa. Do të ishte mirë që shqiptarët të blinin frigoriferë nga vendet e Bashkimit Europian, pra një cilësi më të mirë si çdokush tjetër që banon dhe jeton në Europë.

Faleminderit!

Gramoz Ruçi – Zoti Ministër, dëshironi të shpreheni?

Arben Ahmetaj – Po, jam dakord që ta lëmë ashtu siç është, pra 2 me 10, për të mos cenuar ato pika që me të drejtë dhe shumë saktë tha zoti Braçe.

Gramoz Ruçi – Hedhim në votim amendamentin e paraqitur nga zoti Braçe.

Pro?A ka kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Me miratimin e këtij amendamenti bie i gjithë projektligji?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Rrëzohet projektligji për miratimin e nivelit të tarifës doganore.

Vazhdojmë me projektligjin tjetër “Për taksat kombëtare”, të ndryshuar”.

Përpara se të fillojmë votimin e projektligjit, dua të pyes relatorin nëse ka ndonjë gjë me mendimin që u shpreh?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk ka. Fillojmë me miratimin e neneve.

Neni 1. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Përpara se të kalojmë te neni 2, kemi të depozituar amendamentin e deputetit Braçe, i cili e ka paraqitur 24 orë përpara seancës. Edhe ky amendament konsiston në heqjen e pikës 1 të nenit 2 të projektligjit.

Zoti Braçe, dëshironi të shpreheni?

Erion Braçe – I nderuar zoti Kryetar,

Të nderuar kolegë,

Për të gjitha mineralet metalore, me ligjin që është propozuar nga qeveria, por edhe mbështetur nga komisioni, është vendosur një nivel i ri për rentën minerare, pra për mineralet e papërpunuara në vend, ndërsa për mineralin e përpunuar unë kam propozuar që të ngelet në fuqi niveli i rentës minerare që është sot. Kjo është e para.

E dyta, siç e ka parashikuar ligji, ashtu të mbetet.

Faleminderit!

Gramoz Ruçi – Zoti Ministër, dëshironi të shpreheni?

Arben Ahmetaj – Me keqardhje e them që qeveria do të ecë në logjikën që ka vendosur edhe me komisionin, pra duke mos e mbështetur amendamentin e zotit Braçe dhe të ngelet ashtu siç e kemi vendosur në komision në vitin 2018, të jetë 3-7%, në vitin 2019 të jetë 3-8% dhe në vitin 2020 të jetë 3-9% dhe aty do të stopojë raportin. Pra, në ligj raportin të jetë i qartë 3-7, 3-8 dhe 3-9.

Faleminderit!

Gramoz Ruçi – Me kartonë hidhet në votim amendamenti i propozuar nga zoti Braçe. Pro? Kundër? Abstenim?

Rrëzohet amendamenti.

Vazhdojmë me nenin 2, me vërejtjet e komisionit përgjegjës për pikën 1 dhe shtim të pikës 8/5. Pro? Kundër? Abstenim?

Neni 2 miratohet.

Neni 3. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 4. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 5. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 6, me vërejtjet e komisionit përgjegjës për riformulim neni. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 7. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi.

Hapet votimi.

Mbyllet votimi.

74 vota pro, asnjë kundër dhe asnjë abstenim.

Miratohet.

Projektligji për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8438, datë 28.12. 1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”

Neni 1. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Përpara se të kalohet në nenin 2, kemi të depozituar një amendament nga zoti Braçe, i cili konsiston në shtimin e një neni të ri pas nenit 1.

Zoti Braçe, dëshironi të shpreheni?

Erion Braçe – Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar kolegë, të gjithë e dini që libri në këtë vend po kalon një krizë, që nuk vjen nga konkurrenca e teknologjisë, por është një krizë që vjen nga mundësitë e botuesve, e tregtuesve dhe e atyre që lexojnë e blejnë libra. Për t'i ardhur në ndihmë këtij sektori, i cili është një ndër sektorët më jetik në vend për sa i përket dijes, informacionit, botës së ideve e të tjera me radhë, kam propozuar që në nenin 8/1 “Të ardhurat e përjashtuara” pas pikës 13 të shtohet pika 14 me këtë përmbajtje: “Të ardhurat e përfituara nga personat fizikë ose juridikë, që ushtrojnë tërësisht veprimtarinë e shitjes së librave në mjedise tregtare të jenë të përjashtuara ose ta kenë tatimin mbi fitimin 0”. Pra bëhet fjalë për libraritë dhe për librashitësit. Më lejoni t'ju kujtoj se numri i librarive në këtë vend është kufizuar në mënyrë të frikshme dhe nuk krahasohet me numrin e sallave të lojërave të fatit në këtë vend, ku ka pasur një konkurrencë të

padrejtë dhe të pandershme në këtë aspekt, por edhe ato që janë ekzistuese po vijnë dhe po tkurren. Veprimtaria e libërshitjes është një veprimtari në vështirësi dhe pikërisht për këtë arsye kam propozuar që tatimfitimi për ta të jetë zero. Unë mendoj që kjo i krijon një mundësi akoma më të madhe librit që të tregtohet denjësisht dhe lexuesit të blejnë libra pa këtë kosto mbi kurriz.

Do të jetë mirë që të nxisim krijimin e librarive të reja në qytetet tona. Këtu nuk po flas për fshatin, sepse nuk e gjen dot një libër, por po flas për qytetet si Tirana, ku sot numri i librarive është me numrat e gishtave dhe të gjitha të përqendruara brenda unazës së vogël. Nëse dilni jashtë unazës së Tiranës mund të gjeni çdo gjë, duke filluar nga klubet, kafenetë, restorantet dhe sallat e lojërave të fatit, por nuk mund të gjeni një librari, ta lëmë pastaj në fshatra. Prandaj propozimin e shikoj të arsyeshëm për t'u marrë parasysh për ta bërë tatim fitimin 0 për veprimtarinë e librashitjes në këtë vend.

Faleminderit!

Gramoz Ruçi – Faleminderit, zoti Braçe!

Fjalën e ka zoti Ministër.

Arben Ahmetaj – Besoj se ne e kemi realizuar me kohë këtë që tha zoti Braçe, duke i vendosur taksën 0 biznesit të vogël deri në 5 milionë dhe taksën 5% deri në 14 milionë, prandaj kjo është e zgjidhur. Në të njëjtën kohë ka një konvergjim drejt teknologjisë nga libri i printuar tek teknologjia, e cila nuk frenohet me asnjë lloj mundësie fiskale, sepse produktiviteti i teknologjisë sigurisht që është eksponencial. Prandaj ne e kemi zgjidhur këtë pjesë me taksën 0 për biznesin e vogël dhe me 5% deri në 14 milionë, në të njëjtën kohë te TVSH-ja po bëjmë edhe TVSH-të e reduktuara.

Faleminderit!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Gramoz Ruçi – Nuk ka komente të tjera.

Hidhet në votim amendamenti i zotit Braçe.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të lutem, Erion, nuk ka sqarime në seancë, ju e dini Rregulloren. Ju keni të drejtë të paraqisni amendamentin dhe jo të sqaroni ministrin.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Hapet votimi me elektronikë për amendamentin e zotit Braçe.

Vazhdon votimi i deputetëve që nuk kanë marrë pjesë. Ju lutem!

Atëherë 12 pro, 47 kundër, 15 abstenim.

Prëzohet!

Para se të kalojmë te neni 2, nga zoti Braçe është depozituar përsëri një amendament, i cili konsiston në ndryshimin e pikës 2 të nenit 2 të projektligjit.

Zoti Braçe, argumentet tuaja!

Erion Braçe – Argumentet e mia për këtë pikë burojnë nga një seancë e mëparshme, e zhvilluar këtu në sallën e Kuvendit, ku ramë dakord që, kur të bëhej diskutimi i paketës fiskale, dhe natyrisht të diskutoheshin nenet e tatimit mbi fitimin, pa asnjë lloj diskutimi do të kishim paraqitur edhe këtë amendament. Natyrisht, u la edhe kohë e mjaftueshme për t'u shqyrtuar kjo gjë.

Cili është amendimi? Jo vetëm te ky nen, te pika 2, por edhe te nenet vijuese, për të mos e marrë fjalën më pas, te neni 7, e pastaj edhe te neni 8, amendimi ka të bëjë me rritjen e tatimit mbi fitimin, në lidhje me lojërat e fatit, nga 15 % në 30 %.

Natyrisht, në lidhje me këtë ka argumente të ndryshme. Ne kemi ndërmarrë një nismë të fortë e të lëvdur botërisht, por edhe publikisht në Shqipëri: mbylljen e aktivitetit të lojërave të fatit. Natyrisht, për sa kohë kemi lënë disa segmente të aktivitetit të lojërave të fatit, pa asnjë lloj diskutimi për ato segmente kemi vendosur të aplikojmë, ose unë mendoj se duhet të aplikojmë, një tarifë të re tatimore. Ka një argument që qarkullon, që ne e kemi përdorur këtë edhe si incentivë për të tërhequr aktivitete të ndryshme në turizëm. E kemi përdorur si incentivë për hotelet me 4, 5, 6 yje e kusur. Natyrisht, është bërë mirë, por nga momenti kur kemi vendosur kufizimin, që ky aktivitet do të ushtrohet vetëm në këto struktura, pa asnjë lloj diskutimi që e kemi dhënë incentivën.

Nga ana tjetër, për sa kohë që e kemi dhënë këtë incentivë, e kanë marrë vetëm ky grup subjektsh, me ligje të posaçme, qoftë për turizmin, qoftë për "Ligjin për lojërat e fatit", pa asnjë lloj diskutimi është kërjt legjitime të ketë një normë të re tatimore. Sipas meje, kjo normë e re tatimore duhet të jetë 30 %.

Ky është amendimi. Për të mos e marrë pastaj sërish fjalën për nenin 7 apo nenin 8, kjo

ide le të reflektohet në të gjitha nenet e këtij projektligji ku përmenden lojërat e fatit.

Faleminderit!

Gramoz Ruçi – Faleminderit, zoti Braçe!

Zoti Ministër!

Arben Ahmetaj – Siç e kujtojmë të gjithë, praktikisht lojërat e fatit brenda 5 yjeve dhe resorteve janë incentivë, në mënyrë që të përmirësohet kthimi i investimit në turizëm. Pra, nuk është logjikë thjesht e lojërave të fatit. Unë besoj se kjo kërkon një diskutim shumë më të maturuar, kur të shikohet pas X vitesh logjika e lojërave të fatit në Republikën e Shqipërisë, pas mbylljes që po u bëjmë. Kështu, unë i kërkoj grupit, që të jemi kundër këtij amendamenti, dhe ta rishikojmë kur të kemi një maturim të kësaj gjëje.

Gramoz Ruçi – Atëherë vazhdojmë me votimin.

Hapet votimi me elektronikë, në lidhje me amendimin e paraqitur nga zoti Braçe.

Vazhdoni votimin, ju lutem!

6 vota pro. 59 kundër, 11 abstenime.

Nuk miratohet!

Para se të kalojmë te neni 2...

(Ndërhyrje nga salla)

Urdhëroni?

Zotëri, ky nuk është vendim personal, që ju të shpjegoni votën.

(Ndërhyrje nga salla)

Vazhdoni!

Paulin Sterkaj – Nuk jam me Braçen për këtë amendament, por nuk jam as me ministrin, sepse unë këtë nuk e kuptoj. Heqja e lojërave të fatit është bërë në masë absolute te sporti, te bixhozi, te lojërat elektronike, por është dhënë për hotelet me 4 - 5 yje, për resortet e më the e të thashë.

Pra, këtu nuk është hequr bixhozi për njerëzit. Këtu bixhozi ekziston. Jam edhe kundër rastit të resorteve. Nëse hiqet, le të hiqet në mënyrë absolute nga çdo institucion turistik apo privat. Jam kundër asaj që thotë Braçe, që t'i vëmë 30-përqindëshin ngaqë ata do të fitojnë shumë. Nëse i lejojmë, duhet të veprojmë sipas rasteve që janë në rajonin tonë apo në mbarë Europën.

Në të vërtetë, unë jam me idenë që lojërat e bixhozit të hiqen fare. Të mos lejohen as në hotelet me 5 yje e as me 6 yje, sepse kështu po bëjmë ndarje sipas shtresave. Të pasurit, ata që

shkojnë nëpër hotele me 5, 6 a 7 yje, paskan të drejtë të luajnë, ndërsa të varfrit s'e paskan të drejtë të ndjekin lojërat e fatit.

Kaq kisha.

Faleminderit!

Gramoz Ruçi – Po, zoti Kryeministër!

Edi Rama – Është shumë pozitive që ne bëjmë debate, amendamente, bëjmë edhe opozitën e këtij parlamenti. Praktikisht, e gjithë dita e sotme ka qenë shumë e frytshme, sepse janë bërë përmirësime të rëndësishme në të gjithë draftin e buxhetit, edhe në paketën fiskale. Besoj se mesazhi i këtij buxheti dhe i kësaj pakete fiskale është shumë pozitiv, pavarësisht se fokusi në këtë seancë tek disa amendamente mund të krijojë një ide pak më ndryshe. Për sa i përket rastit konkret, dëshiroj të kujtoj se në Shqipëri, akoma sot që flasim, nuk kemi asnjë hotel me 5 yje dhe me 5 yje kam parasysh atë definicion që përmban edhe incentiva, brand, global, i certifikuar. Nëse duam të zhvillojmë turizmin dhe të jemi konkurrues në rajon, pa llogaritur të gjithë Mesdheun, i kemi të gjitha mundësitë dhe duhet të shikojmë se çfarë bëjnë të tjerët.

Falë ndryshimeve që kemi bërë në legjislacion vitin e shkuar, në mos gabohem, sot kemi një potencial prej rreth 15 brandesh globale që kanë shprehur interes për të investuar në Shqipëri, që do të thotë ndryshim katërcipërisht i të gjithë strukturës së industrisë së turizmit. Kjo masë e vendosur në paketën e mbështetjes për hotelet me 5 yje, që nuk janë hotele, nuk është një mbështetje që qeveria u bën të pasurve, por mbështetje për ekonominë, sepse është ajo fashë e turizmit që sjell të ardhura më të larta në ekonomi, që sjell punësimin më cilësor në vend dhe që sjell një efekt zinxhir në produktivitetin e brendshëm.

Kjo është logjika e kësaj qasjeje të qeverisë për këtë fashë.

Ne nuk mund të ndryshojmë një incentive sot, kur akoma s'kemi një hotel dhe një resort me 5 yje, siç ka Mali i Zi, siç ka Kroacia, siç ka Sllovenia, për të mos folur pastaj për Greqinë, Italinë, Spanjën e Francën, sepse do të jepnim mesazhin më të gabuar për investitorët, të cilët, siç e thashë, janë afro 15, dhe kanë shprehur interes e po diskutojnë me qeverinë shqiptare.

Kjo është arsyeja dhe nuk ka lidhje fare me ndalimin e bixhozit apo me lejimin e bixhozit. Është thjesht pjesë e një incentive.

Kur ne t'i kemi këto, mund të diskutojmë nëse do të rrisim apo nuk do të rrisim taksën. Por nuk mund të rrisim një taksë për diçka që nuk e kemi fare, duke dhënë një mesazh komplet të gabuar tek investitorët. Për më tepër, është e rëndësishme të shikojmë si e kanë vendet e tjera. Kur them vende të tjera, e kam fjalën për rajonin.

Kemi arritur të bëjmë një paketë pozitive, që na ka vënë në avantazh në raport me të tjerët, pikërisht se kemi dhënë disa incentiva. T'u qëndrojmë këtyre. Të jemi seriozë në raport me mesazhet që u japim investitorëve. Në një moment tjetër, të dytë, kur shpresoj të kemi një gjeneratë të parë hotelesh me 5 yje, parlamenti mund ta ridiskutojë, mund të bëjë të tjera veprime dhe mund të marrë të tjera masa. Por sot nuk mund të taksojmë asgjënë, sepse praktikisht i bie të taksojmë asgjënë.

Gramoz Ruçi – Atëherë vazhdojmë me votimin e nenit 2.

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet!

Neni 3.

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet!

Neni 4.

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet!

Shtohet nen i ri, neni 4/1, me formulim sipas raportit të komisionit përgjegjës.

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet!

Neni 5, me vërejtjet e komisionit përgjegjës, për shtimin e paragrafit të shkronjës "b" të pikës 1.

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet!

Neni 6.

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet!

Në lidhje me nenin 7, ka dy amendime të bëra nga zoti Braçe, të cilat, siç ai tha, u votuan tek neni 2. Bien automatikisht.

Hedhim për votim nenin 7.

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet!

Edhe për nenin 8 kemi të depozituar një amendim nga zoti Braçe, amendim i cili, siç bëri argumentimin zoti Braçe, bie për arsyet që u votuan tek neni 2.

Me nenin 8, siç është paraqitur, kush është dakord?

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet!

Para se të kalojmë te neni 9, kemi të depozituar përsëri një amendim nga zoti Braçe. Amendimi konsiston në zëvendësimin e pasqyrës numër 1, te neni 9 i projektligjit.

Zoti Braçe, dëshironi të thoni diçka?

(Deputeti Braçe flet nga salla.)

Si s'ka?

(Deputeti Braçe flet nga salla.)

Atëherë votohet neni 9, siç është paraqitur.

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet!

Neni 10.

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet!

Hapet votimi me elektronikë, në tërësi.

(Deputeti Braçe flet nga salla.)

Po për këtë ju thashë pra, për pasqyrën te neni 9.

Erion Braçe – Ah, më falni! Ju kërkoj ndjesë unë atëherë!

Gramoz Ruçi – Thashë: amendimi konsiston në zëvendësimin e pasqyrës numër 1, tek neni 9 i projektligjit.

Erion Braçe – Ju kërkoj ndjesë. Nuk e vura re.

Atëherë, i nderuar kryetar, propozimi këtu konsiston në mbrojtjen e një fashe, në një nivel të ri të të ardhurave nga puna. Natyrisht, i gjithë ky diskutim zhvendoset edhe në një plan tjetër. Unë mendoj se ka ardhur koha që ligji për tatimin mbi të ardhurat të ndryshojë. Pas kaq e kaq vitesh dhe transformimesh kaq të mëdha që ka pësuar ekonomia shqiptare, por edhe të ardhurat e individëve e të kompanive në këtë vend, pas armimeve që i janë bërë kohë pas kohe, duke reflektuar politika të vlefshme për këtë maxhorancë, dhe natyrisht të dëmshme për ata që kanë qenë deri dje në maxhorancë, ka ardhur momenti që ligji të rishikohet plotësisht.

Në këtë kontekst, pa asnjë lloj diskutimi, unë mendoj se ky vend ka nevojë të mbrojë një fashë të ardhurash, të cilat janë të domosdoshme për çdo familje.

Ndodh rëndom në këtë vend, që të ardhurat totale të familjes janë të ardhura thjesht e vetëm nga puna, ndodh të jenë të ardhura thjesht e vetëm nga një rrogë, ashtu siç ndodh të kenë të

ardhura që vijnë edhe nga drejtime të tjera, si nga qiradhënia, nga aksionet, edhe nga dividendi e kështu me radhë. Do të duhet që ne të bëjmë një debat. Kemi një diskutim për të integruar të gjitha të ardhurat e një familjeje, për t'i deklaruar ato dhe për t'ia nënshtruar një takse apo një tarife, apo një tatim progresiv mbi të ardhurat në total. Dhe në rast se ndodh kjo, pa asnjë lloj diskutimi do të duhet që ne të mbrojmë të ardhurat e ulëta, të ardhurat minimale, që garantojnë për një familje. Ndodh në çdo vend të Europës kjo dhe natyrisht që duhet ta bëjmë edhe ne dhe ka arsye se pse duhet ta bëjmë edhe ne, sepse norma e rritjes së të ardhurave nga puna me normën e rritjes së të ardhurave nga kapitali pa asnjë lloj diskutimi që nuk ka asnjë rast që të barazohet ndonjëherë, do të jetë e tillë. Në kushtet kur është e tillë pabarazia, do të jetë sfida me të cilën duhet të përballemi nga mëngjesi deri në mbrëmje.

Të dhënat që disponojnë sot organet fiskale (m'i kanë vënë edhe mua në dispozicion) referojnë pikërisht këtë fakt.

Mjafton t'ju them që nga shuma e pagave të paguara të deklaruara gjatë vitit 2017 prej gati 11,8 të 20 miliardë lekëve, paga deri në 400 mijë lekë të vjetra zënë vetëm 2,5% të të gjithë totalit të vlerës së paguar si rroga, si të ardhura nga puna në këtë vend. Ndërkohë, vini re këtë shifër! Të ardhurat për paga mbi 4 milionë lekë zënë gati 3,9 miliardë lekë, shkojnë gati 4 miliardë lekë dhe zënë gati 20% të të gjitha rrogave të paguara në Republikën e Shqipërisë.

Pikërisht për këtë arsye unë mendoj se jemi në hapat e parë të këtij fenomeni kaq të madh të pabarazisë edhe tek të ardhurat nga puna, për të mos folur pastaj për të ardhurat nga puna në raport me të ardhurat nga kapitali. Po të shikosh nivelin e xhiros së realizuar për vitin 2017, xhiroja për bizneset nga 0 deri në 14 milionë lekë, xhiroja vjetore, është sa 1,8% e gjithë xhiros vjetore të sipërmarrjes në këtë vend. Po të shohësh pastaj edhe nivelin e fitimit të realizuar, është shumë evident fakti që nga 0-14 milionë lekë fitimi i realizuar dhe i deklaruar, duke pasur brenda, pa diskutim, edhe evazionin fiskal, është vetëm 2,2% e fitimit të realizuar nga gjithë sipërmarrja tjetër, nga 14 milionë xhiro e sipër.

Kështu që unë mendoj se jemi në momentin e duhur për të filluar të përballemi me një

problem shumë madhor, me të cilin po përballlet gjithë bota, në fakt, që ka të bëjë me pabarazinë.

Në rast se ne fillojmë ta adresojmë që tani, unë mendoj se kemi të gjitha mundësitë për të qenë të suksesshëm, por në rast se sot buxheti i shtetit nuk ka mundësi, sepse fatura e kësaj mase shkuara 4,6 miliardë lekë, pa asnjë lloj diskutimi, ta bëjmë këtë diskutim pjesë të proceseve tona për 3 muajt në vijim, me qëllim që të kemi një ligj mbi të ardhurat që të reflektojë dhe të godasë pa asnjë lloj hezitimi pabarazinë në këtë vend.

Faleminderit!

Gramoz Ruçi - Faleminderit!

Urdhëroni, zoti Ministër!

Arben Ahmetaj – Besoj se është rast i mirë për t'iu rikthyer historisë së kësaj maxhorance me gjithë ngarkesën fiskale, pra me taksën progresive dhe taksën e sheshtë. Taksa e sheshtë u merrte shqiptarëve, pjesës më të ngarkuar, 10% nga paga dhe e çonte në buxhet dhe pastaj qeveria e dikurshme e bënte rrush e kumbulla.

Janë 120 milionë, bashkë me ndryshimin që po bëjmë sot, 123 milionë dollarë në vit, të cilat shkojnë në xhepat e qytetarëve dhe gjithë progresiviteti ka bërë këtë në themel. 97% e të punësuarve kanë ulje taksash dhe 97% e të punësuarve, brenda këtij segmenti, ka një segment të madh nga 1 lek deri në 300 mijë lekë të vjetër, pagë që është e përjashtuar nga tatimi mbi të ardhurat personale dhe numri i të punësuarve, brenda kësaj fashe është 55% dhe fasha nga 300 - 400 taksohet vetëm 1,89%, pra është një taksim simbolik në konceptin e mbajtjes në burim të tatimit, vetëm për të qenë brenda sistemit. Pra, mos harroni se kemi 55% dhe kemi bërë shumë mirë që e kemi jashtë taksimit, megjithëse teoritë fiskale kërkojnë që në përgjithësi të gjithë të kontribuojnë në sistemin fiskal, qoftë edhe në mënyrë minimale. Kjo ishte për të ardhurat nga puna.

E dyta, të ardhurat nga kapitali. Ne e kemi nga 0-5 milionë tatimfitimin zero dhe nga 5-14 milionë e kemi 5%. Pra, 91% e sipërmarrjes së vogël (dua ta mbajmë në kujtesë këtë shifër se është e rëndësishme) paguan ose 0%, ose 5%, dhe vetëm 9% e sipërmarrjes në Republikën e Shqipërisë paguan 15%. Ndërkohë, kemi sektorë të cilëve u referohemi si sektorë me të ardhura të ulëta, siç është bujqësia, që e kemi përjashtuar

komplet nga tatimet dhe taksat, madje e subvencionojmë në vazhdimësi.

Unë mendoj se kemi një pasqyrë të konsoliduar që e ndihmon punësimin, e ndihmon të punësuarin me paga të ulëta dhe sigurisht që ruan një balancë shumë të drejtë midis të drejtës fiskale dhe ngarkesës fiskale, kështu që do të sugjeroja ta rrëzonim amendamentin.

Faleminderit!

Gramoz Ruçi – Urdhëroni, zoti Kryeministër!

Edi Rama - Duke qenë se është bërë për një periudhë jo të shkurtër, gjatë diskutimeve të buxhetit, ky debat rreth paketës fiskale dhe duke qenë se unë kam mundur ta ndjek nga afër këtë diskutim, por duke pasur edhe parasysh që Fondi Monetar Ndërkombëtar e ka nisur historinë e marrëdhënies me ne në vjeshtën e 2013-s, me kërkesën për të ulur pagat dhe pensionet dhe sot e gjithë ditën i qëndron kërkesës për të zbritur më poshtë nivelin e taksimit të pagës, pra për ta filluar taksimin e pagës nga 150 mijë lekë të vjetra, gjë që, natyrisht, ne e kemi refuzuar dhe vazhdojmë e refuzojmë, atëherë është mirë që të mos dalim nga konteksti në të cilin jetojmë.

Kemi pasur një periudhë shumë të vështirë vendosjeje rregulli në llogaritë e shtetit. Natyrisht, qeveritë dhe shumicat qeverisëse vlerësohen për çka ndodh, por një shprehje thotë që “ekonomistët i vlerësojnë qeveritë dhe shumicat qeverisëse edhe për atë që pengojnë të ndodhë, për atë që nuk ndodh dhe që mund të kishte ndodhur”. Faktikisht, kjo shumicë qeverisëse, kjo parti, ka meritën që ka penguar të ndodhë një katastrofë e dytë, pas asaj të '97-s, pikërisht kur ne morëm mandatin e parë dhe ishim në prag të një falimentimi të plotë, për të cilin na u desh të thërrasim Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe të fillojmë një periudhë shumë të vështirë reformash që nuk ka nevojë t'i numërojmë.

Ajo që është shumë e rëndësishme të mos harrohet është se, sidoqoftë, pavarësisht se u futëm në atë lloj cikli reformash të vështira, ne i qëndruam qysh në buxhetin e parë premtimit për të kaluar nga taksa e sheshtë, që ishte një grabitje e mirëfilltë e atyre që fitonin më pak, tek taksimi i ndershëm. Kush fiton më shumë, paguan më shumë.

Sot është mirë të rikujtojmë se, pavarësisht nga çfarë thuhet, ne jemi shumica që kemi

taksuar më fort se gjithë të tjerët ata që fitojnë më shumë. Kemi taksuar më fort biznesin. Ata, të cilët konsiderohen sipërmarrësit e mëdhenj dhe rëndom quhen këtu me një shprehje që nuk ka lidhje fare, oligarkë, sot paguajnë më shumë sesa kanë paguar ndonjëherë në gjithë periudhën e zhvillimeve demokratike. Kontribuojnë në buxhetin e shtetit më shumë se ndonjëherë tjetër.

Ndërkohë që ata që fitojnë më pak, biznesi i vogël pagan më pak sesa ka paguar ndonjëherë në gjithë historinë e zhvillimeve demokratike. Kur të më tregoni një vend në rajon që e takson biznesin e vogël zero deri në 5%, atëherë e diskutojmë si ta bëjmë më pak. 0 deri në 5%, me xhiron 140 mijë dollarë në vit. Kur të ma gjeni një biznes me xhiro 140 mijë dollarë në vit, në Serbi, në Malin e Zi, në Maqedoni, në Kosovë, në Bosnje dhe ku të doni tjetër në rajon, po të doni ngjituni edhe më lart, ose zbrisni dhe më poshtë, në Greqi, që taksohet vetëm 5%, atëherë e diskutojmë si ta relaksojmë më shumë.

Pagat 300 deri në 400 mijë lekë, është mirë ta kujtojmë, taksoheshin 10%. Sot taksohen më pak se 2%, 1,89.

1,89 është një taksim, i cili është një kontribut në raport me ata që e kanë 300 e poshtë e që nuk paguajnë asgjë. Pra, fillon progresiviteti dhe është gjëja më normale, prandaj unë kam qëndruar ashtu si shumica e grupit parlamentar dhe shumica e qeverisë, në pozicionin as andej, as këtej, as me idenë që të zbresim më poshtë tek 150 mijëlekëshi, sepse bie ndesh me një parim që e kemi vendosur që në fillim dhe as me idenë që të fillojmë dhe të zerojmë mbi 300-mijëlekëshin.

Thënë kjo, është mirë të mos e harrojmë që sot jemi duke kaluar një për një të gjitha pikat e një buxheti dhe të një pakete fiskale që ka lajme shumë pozitive për opinionin publik dhe për shumë aktorë dhe po ashtu edhe faktorë ekonomikë dhe socialë, rritje pagash në kategoritë kryesore që i kemi përmendur; nga ana tjetër, lehtësime fiskale. Këtu u fol për libraritë. Mbas kaq shumë vitesh, sot vijmë te zbritja e TVSH-së mbi librin. Shkojmë në 6% nga 20%.

Unë e kuptoj që dashamirësit e librit mund ta duan edhe nën zero, madje këtu mund të duhet edhe që të paguajmë nga buxheti i shtetit këdo që lexon, mund të vijmë edhe tek kjo kërkesë për të stimuluar librin, kush lexon, t'i japim edhe lekë,

por sot për sot këto janë mundësitë. Nuk kemi mundësi të pakufizuara. Brenda mundësive të reja që kemi krijuar, shkojmë përpara, duke bërë hapa të rëndësishëm.

Kjo është shumë themelore të nënvizohet, se do të vijmë më pas prapë te debati tjetër. Në 28 vjet, ata që punojnë tokën morën premtimin nga të gjithë, edhe nga ne, se do t'u heqim barrën mbi inputet bujqësore, mbi të gjitha inputet bujqësore. Sot jemi në ditën kur këtë e votojmë dhe e vendosim mbas 28 vjetësh.

Do të kishim dashur ta bënim më parë. E kemi premtuar në 2013-n. Kaloj një mandat e nuk e bëmë dot. Pse? Nuk na u krijua mundësia që ta bënim. Këtu nuk është çështje dëshire. Këtu nuk jemi të ndarë në disa që e kanë zemrën që u rreh më majtas e disa që e kanë zemrën në të djathtë të kraharorit. Këtu çështja është të vlerësojmë mundësitë, sepse siç i thonë, “deti nuk u bë kos”. Këtu jemi dhe hap pas hapi do të bëjmë më shumë, duke krijuar më shumë mundësi.

Këtë desha të them për të çuar tek të gjithë mesazhin se kemi buxhetin dhe paketën më të balancuar ndonjëherë midis lehtësimit për ata që fitojnë më pak dhe ngarkesës për ata që fitojnë më shumë. Por të mos e harrojmë kurrë: ne nuk jemi armiq të atyre që kanë më shumë. Problemi nuk janë ata që kanë më shumë, problemi është varfëria. Varfëria nuk luftohet duke i bërë të gjithë të varfër, varfëria luftohet duke nxjerrë sa më shumë të varfër nga ajo zonë. Kështu që, me gjithë respektin për “jelekët e verdhë”, unë besoj se ne jemi në rrugën e duhur.

Gramoz Ruçi - Faleminderit, zoti Kryeministër!

Hedhim në votim amendimin e zotit Braçe.

Hapet votimi me elektronikë.

Mbyllet votimi.

1 pro, 63 kundër, 12 abstenime.

Nuk miratohet.

Neni 9. Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 10.

Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Hapet votimi me elektronikë në tërësi.

Po, zoti Braçe.

Erion Braçe - Në të gjithë këtë debat, besoj se lamë dy detyra.

Së pari, në një të ardhme të afërt të rishikojmë tatimin për lojërat e fatit, kështu u tha apo jo, pasi të kemi korpusin e krijuar për ato struktura që kemi përcaktuar me ligj, që do t'i incentivojmë në turizëm.

Së dyti, lamë detyrën tjetër për të riparë nga themeli ligjin "Për tatimin mbi të ardhurat". Janë dy detyra që Kuvendi mund t'ia lërë fare mirë qeverisë, me qëllim që vitin e ardhshëm ne të kemi mundësi të diskutojmë apo të bëjmë një debat të thelluar për këtë çështje, sepse mendoj se është momenti për ta adresuar edhe një herë këtë gjë.

Për ta tejkaluar Kryeministrin, pa asnjë lloj diskutimi, që nga data 1 ne bëjmë një favorizim të fortë për të gjitha bizneset e fashës nga 2-14 milionë lekë, që nuk ishte bërë kurrë më parë. Natyrisht ia vlen që sot...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Fajësie?!

Për çfarë?! Që e kam propozuar unë?! Po, unë e kam propozuar edhe atë. Po, besoj se e mban mend se kush ishte pro dhe kush kundër. E lëmë këtë histori, se nuk ia vlen.

Por ia vlen për ta theksuar këtë gjë edhe në një aspekt tjetër, ka dalë dikush tjetër dhe thotë: "Do t'ua bëj 9%", pra nga 5 % do t'ua rrisë dhe do t'ua bëjë 9%. Pra, do t'ua rrisë me 2 -fish. Ky quhet Lulzim Basha.

Kemi bërë të njëjtën gjë për turizmin, për agroturizmin, siç kemi bërë të njëjtën gjë edhe për shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor dhe blegtoral me të cilat duhet shumë punë për t'u mbushur mendjen bujqëve. Por, pavarësisht të gjitha këtyre, në momentin që 97% e fitimit shkon te sipërmarrja nga 14 milionë lekë e lart, pa asnjë lloj diskutimi unë vazhdoj t'i qëndroj idesë sime që ne duhet ta diskutojmë ende më fort këtë çështje.

Faleminderit!

Gramoz Ruçi - Hapet votimi me elektronikë në tërësi.

Mbyllet votimi.

75 vota pro, asnjë kundër, asnjë abstenim.

Miratohet në tërësi.

Vazhdojmë me projektligjin "Për sistemin e taksave vendore", të ndryshuar.

Neni 1, me vërejtjet e komisionit përgjegjës për zëvendësimin e aneksit nr.1, që i

bashkëngjitet projektligjit. Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 2. Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 3. Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 4, me vërejtjet e komisionit përgjegjës për pikën 1, germa "a". Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Po në nenin 4 kemi depozituar amendimin e deputetit Erion Braçe.

Zoti Braçe, dëshironi të paraqisni arsyet tuaja?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Erion Braçe - Patjetër, i nderuar zoti Kryetar!

Veçanërisht, dua ta marr fjalën për pikën e parë të propozimit, sepse për pikën e dytë u kuptuam, u morëm vesh. Unë dhe një grup kolegësh u bëmë iniciatorë për këtë ndryshim dhe duhet të falënderoj zonjën Bushka, zonjën Hysi dhe të gjithë kolegët e Komisionit të Ekonomisë, i cili bën fjalë për ndërtesat që janë në pronësi apo në përdorim të organizatave jofitimprurëse të licencuara nga organet e qeverisjes qendrore dhe kanë lidhur një marrëveshje me organet e qeverisjes qendrore apo vendore si ofrues shërbimesh komunitare falas, veçanërisht për personat me aftësi ndryshe. Bëhet fjalë për taksën e ndërtesës. Ne mendojmë se taksa e ndërtesës për këto organizata të bëhet zero.

Unë mendoj se është krijuar një korpus i vogël organizatash që ofrojnë shërbime falas për personat me aftësi ndryshe, po e theksoj fort "falas", madje në marrëveshje me organet e qeverisjes vendore dhe do të jetë shumë mirë për ne që ta bëjmë taksën e ndërtesës për to zero.

Unë po kthehem përsëri te kjo histori, sepse është propozimi i tretë në radhë që kishte të bënte me libraritë, taksa për ndërtesat që përdoren nga personi fizik ose juridik që ushtron tërësisht veprimtarinë e shitjes së librave në mjediset tregtare, të jetë zero. Pra, taksa e ndërtesës për libraritë të jetë zero. Po e theksoj, të jetë zero.

Unë i dëgjova me shumë vëmendje të gjitha ato që u thanë, madje edhe faktin që libraritë hyjnë te fasha e xhiros nga 0-2 milionë lekë.

Unë e kuptoj që ka njerëz që blejnë libra *online* në internet dhe nuk e dinë çmimin e librave në letër.

Këtu në këtë sallë ka plotë deputetë që shkruajnë, ka edhe shkrimtarë madje, që nuk shkruajnë *online*, por shkruajnë në letër, që prodhojnë dhe botojnë libra në letër (thashë në këtë sallë, sepse jashtë salle dihet që ka shkrimtarë).

Çmimi i një libri shkon 10-20 mijë lekë të vjetër, që, për xhiron deri në 2 milionë lekë, që referohet këtu, gjithë-gjithë bëjnë 1000 libra...

(Ndërhyrje pa mikrofon nga salla)

Boll tani, të lutem! Të kam dëgjuar aq shumë sa nuk ka ku të shkojë më!

Gramoz Ruçi – Zoti Ministër, mos ndërhyri, ju lutem! Do ta merrni edhe ju fjalën.

Erion Braçe – Ki durimin të më dëgjosh një herë edhe mua! Më dëgjo një herë edhe mua!

Bëhet fjalë për 500-1000 libra të shitur gjatë vitit. Më vjen keq, por ka librari që shesin më shumë se 1000 libra, sepse 1000 libra janë shumë pak. Jo vetëm që nuk lexojnë 1 milion njerëz, por me këtë llogari i bie të mos lexojnë 2 milionë e kusur njerëz.

Faleminderit!

Gramoz Ruçi – Zoti Ministër, keni fjalën.

Arben Ahmetaj – E thashë, llogaritë janë të qarta.

Për korrigjim, 0 taksë tatimfitimi është për xhiron 0-5 milionë lekë dhe jo për xhiron 0-2 milionë lekë, për të sqaruar edhe publikun, që të mos ngatërrohet.

Besoj se pushteti vendor e ka këtë të drejtë. Ia kemi dhënë me ligj këtë të drejtë pushtetit vendor, që të bëjë ulje për ato kategori që gjykon këshilli bashkiak. Kështu që besoj se nuk ka nevojë t'i rikthehemi këtij diskutimi.

Sugjeroj që amendamenti në tërësi të rrëzohet.

(Ndërhyrje pa mikrofon nga salla)

Faleminderit!

(Ndërhyrje pa mikrofon nga salla)

Gramoz Ruçi – Hapet votimi me elektronikë për amendamentin e paraqitur nga zoti Braçe.

Janë 16 vota pro, 45 kundër, 13 abstenim.

Nuk miratohet amendamenti i paraqitur nga zoti Braçe.

Neni 5. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 6. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 7. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 8. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 9, me vërejtjet e komisionit përgjegjës, për shtimin e gërmës “ç” në pikën 3. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 10. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 11. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 12. Pro? Kundër? Abstenim?

Neni 13. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 14. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 15. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 16. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë te votimi në tërësi i projektligjit.

Hapet votimi me elektronikë.

Janë 75 vota pro, asnjë kundër, asnjë abstenim.

1 deputet nuk mori pjesë në votim.

Miratohet në tërësi projektligji.

Kalojmë te projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”.”.

Para se të kalojmë te neni 1, është depozituar përsëri një amendim nga zoti Braçe, që konsiston tek TVSH-ja 6% për mjetet e transportit publik. Bëhet fjalë për pikën 7 të nenit 1.

Zoti Braçe, fjala për ju.

Erion Braçe – Është shumë i qartë propozimi, i nderuar Kryetar. Unë kërkoj një shkallë të reduktuar të tatimit mbi vlerën e shtuar për mjetet e transportit publik të udhëtarëve, autobusët 9+1 e sipër, për t'u dhënë një mundësi të re të gjitha qyteteve tona për të shmanhur flotën e vjetër, që përdor karburantet fosile, natyrisht, edhe për të kursyer shpenzimet

marramendëse që kanë këto flota, pavarësisht se kanë edhe problematika të tjera, të cilat refuzohen të adresohen në kohë të ndryshme. Për të krijuar mundësinë që të krijohet një flotë ekologjike, do të ishte mirë që TVSH-ja për autobusët e rinj elektrikë të jetë 6%. E theksoj, për autobusët 9+1 vende e lart.

Faleminderit!

Gramoz Ruçi - Materialet i keni edhe për pikën 7/1, edhe për pikën 8/1.

Do ta merrni fjalën?

Erion Braçe – Atëherë, po vazhdoj, meqë i morëm një nga një pikat.

Po vazhdoj me pikën tjetër, që ka të bëjë përsëri me librin. Nuk kemi çfarë të bëjmë! Këtu bëhet fjalë për një kërkesë të ardhur nga Shoqata e Botuesve të Shqipërisë, të cilën dua ta falënderoj pa fund që një herë në vit organizon panairë, për më tepër, jo thjesht panairë, po shitore për librin, për shkak të atyre që thashë deri tani, dhe u krijon mundësinë të gjithëve të shkojnë atje dhe të blejnë libra edhe me promocion, “merr dy, të japim një falas” e kështu me radhë.

Për t’i çliruar nga kjo lloj politike, që për librin, pa asnjë lloj diskutimi, është e papërshtatshme, kam propozuar që shkalla e reduktuar e tatimit mbi vlerën e shtuar, e cila aplikohet në furnizimin e librit dhe mallrave të destinuara për t’u përdorur vetëm për realizimin e veprimtarisë së prodhimit të librit, të jetë 6%.

Ajo që dëgjova deri tani, natyrisht që nuk ka të bëjë me këtë, por ka të bëjë me ndryshimin e politikës aktuale, që është 20% në blerje dhe 0% në shitje, duke i detyruar këta njerëz të humbin para pa hesap.

Po kërkojmë një politikë që i barazon në mënyrë të qartë këto nivele, edhe në botim, edhe në shitje, me qëllim që të paktën këta njerëz të mos humbin para. Do të ishte mirë të ishte 0%, por po propozoj të jetë 6%, me qëllim që të mos i bëjmë një dëm kolossal buxhetit të shtetit.

Faleminderit!

Ka të bëjë me heqjen e disa neneve, për të cilat duhet diskutim më vete, Kryetar.

Gramoz Ruçi – Kur të shkojmë atje. E ke fjalën gjithmonë për pikat 7 dhe 8 të nenit 1. A u shprehët për këto pika?

Erion Braçe – Po, për pikat 7 dhe 8.

Gramoz Ruçi – Në rregull.

Zoti Ministër.

Arben Ahmetaj – Besoj se vlen edhe një herë sqarimi për atë politikë ambientale të avancuar nga qeveria. Unë kam rënë dakord me të gjithë debatin që kemi bërë në komision dhe kemi materializuar një propozim të përbashkët, midis meje dhe komisionit, që për autobusët për përdorim të transportit publik të licencuar (duhet të shënohet në ligj) shkalla e reduktuar e TVSH-së të jetë 6% dhe pas 3 vjetësh të kalojë 10%. E kemi diskutuar që kjo është një politikë ambientale shumë e mirë. Kështu, unë nuk lëviz asnjë presje nga ajo që ka vendosur komisioni qoftë për këtë, qoftë për të tjerat, pra unë jam me logjikën që kemi vendosur në komision dhe që është paraqitur në raport.

Faleminderit!

Gramoz Ruçi – Meqë kemi të bëjmë me një nen me dy pika, domethënë pikat 7 dhe 8 të nenit 1, i hedhim në votë amendimet e zotit Braçe.

(Zoti Braçe reagon pa mikrofon)

Arben Ahmetaj – Ne e bëmë më të drejtë atë avancim për librin. E gjithë logjika e amendamentit të kërkuar nga zoti Braçe presupozon që për bojën, letrën dhe të gjitha nënproduktet, të cilat nuk përdoren vetëm te libri, por edhe në filozofi fiskale nuk duhen përjashtuar, kërkohet përjashtimi. Ne i kemi përjashtuar dhe i kemi dhënë mundësi industrisë të produkti final, te libri. Prandaj ju theksova se kemi rënë dakord me komisionin dhe komisioni bashkë me mua e ka materializuar saktë atë diskutim që kemi bërë gjatë ditëve të kaluara.

Faleminderit!

Gramoz Ruçi – Atëherë, e hedhim në...

(Zoti Braçe flet nga salla pa mikrofon)

Ju lutem, hedhim në votë nenin 1 me amendimet e pikave 7 dhe 8.

Hapet votimi me elektronikë.

Mbyllet votimi.

58 kundër, 2 pro, 14 abstenime.

Rrezohen.

Hedhim në votë nenin 1 me vërejtjet e komisionit përgjegjës për pikat 7 dhe 8. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 2 me vërejtjet e komisionit përgjegjës për riformulim neni. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 3 me vërejtjet e komisionit përgjegjës për riformulim të pikës 1. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 4. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Para se të kalojmë te neni 5, përsëri kemi të depozituar nga zoti Braçe amendime që konsistojnë në shtimin e neneve të reja 5, 6, 7, 8, 9 pas nenit 4 të projektligjit.

Zoti Braçe, keni fjalën.

Erion Braçe – I nderuar Kryetar, këto amendime përmbajnë disa propozime.

Propozimi i parë lidhet me industrinë e lehtë dhe përpunuese, pra me atë fason. Natyrisht që i gjithë shqetësimi që mundohet të zgjidhë amendamenti ka të bëjë me akumulimin e TVSH-së së rimbursueshme nga organet tatimore dhe zgjatjen në periudha tej çdo logjike të marrjes pas të këtij rimbursimi. Për sa kohë që akumulimi i TVSH-së së rimbursueshme për këto ndërmarrje është kthyer në shqetësim, unë kam menduar, i konsultuar pa asnjë lloj diskutimi edhe me këta njerëz, që të sjell këtë formulim: “Furnizimi i shërbimeve të përpunimit të mallrave joshqiptare të destinuar për t’u rieksportuar nga personat e tatueshëm të autorizuar (bëhet fjalë për fasonin) dhe nënkontraktorët e tyre mbi bazën e dispozitave që parashikon Kodi Doganor për operacionet nën regjimin e përpunimit aktiv, ministri përgjegjës për Financat përcakton me udhëzim dokumentacionin e nevojshëm për zbatimin e shkronjës “ç”. Pra, ajo që synojmë është që të mos akumulohet më TVSH-ja pranë organeve fiskale, të mos zgjatet koha e kthimit pas të kësaj TVSH-je, duke i vendosur këto ndërmarrje në vështirësi. Ashtu siç është propozuar në projektligj nga ana e qeverisë, një kategori shumë e madhe e këtyre ndërmarrjeve humbin para. Ata kanë ardhur e janë takuar me mua dhe me komisionin; janë takuar me deputetë; i kanë bërë llogaritë e qarta dhe kanë vënë në dukje pikërisht faktin që humbin para. Pra, nga një moment, që ka të bëjë thjesht dhe vetëm me radhën e gjatë për të marrë rimbursimin e TVSH-së në organet fiskale, kalohet deri në humbje të parave. Pikërisht për këtë arsye vjen ky propozim, i cili do të zgjidhë edhe problemin e akumulimit të TVSH-së së rimbursueshme për këto subjekte, natyrisht në krahun tjetër të mos

humbim paratë. Kam përshtypjen se, përtej meje dhe Komisionit të Ekonomisë, ky shqetësim u ka shkuar edhe personave të tjerë më të rëndësishëm se ne këtu në këtë sallë.

Së dyti, propozimi im është që të gjitha inputet bujqësore ta kenë TVSH-në zero, por këtu u votua pak më parë varianti i qeverisë dhe u la në fuqi që ato të jenë të përjashtuara nga tatimi mbi vlerën e shtuar.

Tani merreni si të doni, por, para se të flas për përmbajtjen e amendimit që kam bërë, do të doja të falënderoja Kryeministrin e vendit, sepse ka qenë thujtja e vetmi që e ka mbështetur këtë pikë gjatë gjithë kohës.

Dua të falënderoj ministrin e Bujqësisë dhe të gjithë ata persona që punojnë atje, të cilët na kanë asistuar me të dhëna për të mbështetur pikërisht këtë propozim.

Dua të falënderoj të gjithë deputetët e Komisionit të Ekonomisë dhe Financave, që nuk janë lëkundur asnjëherë për të mbështetur këtë propozim. Gjithashtu, dua të falënderoj deputetët e Komisionit të Veprimtarive Prodhuese, të cilët kanë qenë pjesë e kësaj mbështetje, por edhe të gjithë deputetët që janë në sallë të cilët mbulojnë zona rurale. Është siç e thotë Kryeministri, për 23 vjet që të gjithë nga demokratët e vjetër, te demokratët e vjetër, nga socialistët e vjetër deri te socialistët e rinj, të cilët e kanë propozuar ekzaktësisht këtë pikë dhe pas 23 vjetësh, më në fund...

(Reagim pa mikrofon)

23, Kryeministër! 28 mund ta dije... Unë e di 23. Pra, më në fund bëhet realitet një premtim i drejtpërdrejtë, thujtja horizontale, për të gjithë ata që merren me bujqësi në këtë vend.

Kjo do të thotë se propozimi konsiston në përcaktimin e qartë të plehrave kimike dhe pesticideve, me përjashtim të hormoneve të klasifikuara në kodet 29 dhe 37 të nomenklaturës së mallrave në njësi jo më pak se 10 kilogramë, të lëndëve ushqyese të kafshëve, me përjashtim të lëndëve ushqyese dhe të destinuar për përdorim për qentë, për macet, për zogjtë e kafazit ose kafshëve shtëpiake (pra këto që përdoren për qejf dhe për luks në vend të librit); fara dhe fidanë frutorë, bulbet e bimëve, tuberet, rrënjët tuberoze, zhardhokët, kurorat dhe rizomat, të cilat përdoren vetëm për prodhimin e produkteve ushqimore.

Në fund lista e inputeve bujqësore përcaktohet sipas aneksit katër bashkëlidhur këtij ligji. Pra, Kryetar, dua t'ju them se përmbajtja është pothuajse e njëjtë, kjo që kemi bërë ne, sepse e kemi bërë të gjithë si komision dhe është më detajuar. Elementi plus është se lista e inputeteve bujqësore i bashkëngjitet ligjit që po miratojmë ne sipas kodeve respektive. Përndryshe mund të ndodhë që të mos përfshihet e gjithë gama e inputeve bujqësore, që duhet të çlirohen nga tatimi mbi vlerën e shtuar, gjithashtu edhe shërbimi veterinar.

Në nenin 9, që është brenda të njëjtit propozim, thuhet: "Norma e kompensimit të prodhuesit bujqësor", fjalët "20%" zëvendësohen me fjalët "10%". Këtu do t'i bie shkurt, sepse e kuptoj që e kam zgjatur shumë me këtë pjesë dhe duket sikur është ndonjë gjë personale. Me thënë të drejtën, unë nuk merrem me bujqësi, thjesht asistoj një kategori të caktuar. E kam bërë me tabelë, se ndoshta dallohet deri aty.

Sot efekti i uljes së tatimit mbi vlerën e shtuar për inputet bujqësore nga 20% në përjashtim shkon 1,25 miliardë lekë. Ndërkohë, e gjithë vlera e kompensimit apo e rimbursimit të bujqve dhe fermerëve me 20% në vlerë është 2,3 miliardë lekë dhe këtë vit mund të arrijë deri 2,4 miliardë lekë, gjysma, që është 10%-shi, që unë propozoj, i bie fiks 1,2 miliardë lekë. Të dyja masat, në referencë të dëmit që i sjellin buxhetit të shtetit, ekuilibrohen. Pra, në qoftë se sot bujqve po u japim 1,25 miliardë lekë nga ulja e tatimit mbi vlerën e shtuar për inputetet bujqësore, po në të njëjtën masë kompensohet buxheti i shtetit në 1,2 miliardë lekë me vlerën e rimbursimit nga 20% në 10%. Në qoftë se e bëjmë 6% buxheti i shtetit fiton të paktën edhe 500 milionë apo lekë 600 milionë lekë të tjera, të cilat, për fat të keq, nuk shkojnë te bujqësia. Pra, balanca shkon nga 1,2 miliardë lekë në 1,7 miliardë lekë. Në qoftë se bujqit dhe fermerët po i ndihmojmë me 1,25 miliardë lekë, nga ana tjetër, do të ulim masën e rimbursimit në masën 1,7 miliardë lekë. Natyrisht, me qëllim që të ruajmë balancën buxhetore dhe, nga ana tjetër, të mos dëmtojmë bujqit dhe fermerët, them që TVSH-ja për inputet bujqësore të jetë zero dhe 10% norma e rimbursimit të fermerëve.

Dua t'ju kujtoj se norma 10% e rimbursimit të fermerëve, mbi të gjitha, shkon për kompensimin e karburantit, që vazhdon të jetë

një element, të cilin ne e kemi për zgjidhje, dhe, natyrisht, duhet të japim një zgjidhje gjatë këtij mandati. Pa asnjë lloj diskutimi, e gjitha kjo u shkon për shtat atyre politikave që ndërmarrin sot vendet rreth e qark nesh, që kanë subvencionim të drejtpërdrejtë të produkteve të tyre. Imagjinoni kur e bën këtë gjë, fjala bie Greqia, që është një vend i Bashkimit European dhe subvencionon drejtpërdrejt produktet e fermerit, me qëllim që të jetë konkurruese në treg, pa më të voglin diskutim ne, që kemi një bujqësi akoma më të pazhvilluar, duhet ta bëjmë këtë gjë, në mos hapur, edhe fshehur, pse jo.

Faleminderit!

Gramoz Ruçi – Urdhëroni, zoti Ministër, për këto 5 amendime!

Arben Ahmetaj – Ne i kemi sqaruar të gjitha çështjet me komisionin, edhe çështjen e mbështetjes së industrisë fason. Përjashtimi nga TVSH-ja ka qenë një iniciativë e Kryeministrit.

Në diskutimin në komision ka dalë një problematikë për të referuar atë pjesë të nënkontraktorëve, të cilët, përveç punës, kanë edhe inpute të tjera. Në ndryshimet tona ne i jemi referuar mot a mot logjikës së komisionit. Sigurisht, unë do të ngelem te logjika që kemi rënë dakord me Komisionin e Ekonomisë.

Për sa u përket inputeve bujqësore, besoj se kemi bërë një gjë shumë të mirë për të mbështetur fermerin horizontalisht, ka pasur një diskutim qoftë nga ministri i Bujqësisë, qoftë nga komisioni që 20%-shi nuk shkonte te fermeri, u dëgjua me vëmendje, kaloi mbështetja totalisht tek inputet.

Sigurisht, ashtu siç ndodh rëndom në rajon, kompensimi ndjek të njëjtën logjikë. Për shembull, po t'i referohemi Malit të Zi e ka 5%, ne e kemi vendosur 6%, ndërkohë inputet i ka me TVSH të reduktuar 7%, nuk i ka me TVSH të përjashtuar, siç e kemi ne. E njëjta gjë ndodh edhe me Kroacinë, Rumaninë, Çekinë, nuk po shkoj më larg, ku të gjitha plehrat, pesticidet dhe produktet e tjera, inputet e kanë 13% TVSH-në e reduktuar, 9%, 10%, 8% dhe 13%.

Thënë këtë, ne kemi bërë një balancë shumë të mirë mbështetjeje për fermerin, ndërsa eksporti mbështetet në mënyra të tjera. Ndërkohë, eksporti në themel ka sfidën e produktivitetit të sektorit. Kështu që votojmë atë që kemi vendosur në komision.

Gramoz Ruçi – Po, zoti Kryeministër!

Edi Rama – Duke qenë se ky ishte amendimi i fundit, në qoftë se nuk gabohem, unë dua të them dy fjalë pas këtij diskutimi.

Në radhë të parë, dua të falënderoj, sinjerisht, të gjithë pjesëmarrësit në debatin shumëjavor, pa diskutim Komisionin e Ekonomisë dhe të Financave dhe kryetarin e tij, me një vërejtje të vogël, që edhe kur është pro duket sikur është kundër, por kjo i jep më shumë ngjyrë debatit.

Më vjen shumë mirë që në këtë proces ne dolëm me një rezultat goxha inkurajues, me përmirësime të ndjeshme dhe këtë e them, sepse kjo është e vërteta, jo se duhet thënë, ashtu sikundër në këtë proces realisht pati një angazhim të madh dhe të sinqertë të të gjithëve, ku doli në pah edhe një herë tjetër se ne jemi partia që nuk ndahemi për qëllimet, por debatojmë deri në fund për instrumentet.

Më lejoni të sjell në vëmendjen tuaj një element, që, ma ha mendja, është i rëndësishëm për të gjithë ne dhe për publikun, si moment edhe krahasimor me nga e nisëm, por edhe me pellgun ku jetojmë, sepse kur i marrim veç e veç të gjitha gjërat, ato bëjnë sens dhe nuk diskutohet, por, nëse kujtohem për kontekstin e përgjithshëm, atëherë nuk mundet dot t'u japim përgjigje pozitive të gjitha gjërave që duam t'i bëjmë sot. Pse?! Nëse flasim për tatimin mbi fitimin, vendet e tjera e kanë: Maqedonia 10%, Kosova 10%, Kroacia 20%, Mali i Zi 9%, Bosnjë Hercegovina 10%, Bullgaria 10%, Serbia 15%, Rumania 16%, Greqia 29% dhe Shqipëria 5,15%.

Nëse flasim për tatimin mbi të ardhurat personale, vendet e tjera e kanë: Maqedonia 10%, Kosova 10%, Kroacia 47,2%, Mali i Zi 9%, Bosnjë Hercegovina 10%, Bullgaria 10%, Serbia 15%, Rumania 16%, Greqia 46% dhe Shqipëria 13,23%. Duhet të kini parasysh se ato vende që e kanë 10% dhe 9% është taksë e sheshtë, janë 10 për të gjithë. Duke marrë parasysh mesataren, tatimin mbi të ardhurat personale ne e kemi 13,23%. Këtu duhet të kini parasysh se tatimi për të ardhurat personale me vlerën nën 1 milion e 500 mijë lekë të ardhura mujore janë më poshtë sesa të gjitha vendet e rajonit, ndërsa të tjerët me vlerën mbi 1,5 milionë lekë shkojnë më lart, sepse fitojnë më shumë. Kjo është ajo që kemi bërë ne në ecurinë e reformave dhe me qasjen tonë.

Po ju jap edhe një shembull tjetër, që është përsëri shumë i rëndësishëm, kontributet e individëve për mbështetjen sociale dhe për shëndetin. Po marr totalin për kontributet e vendeve të tjera, të cilat e kanë: Maqedonia 27%, Kroacia 37%, Mali i Zi 32%, Bosnja 40,5%, Bullgaria 31,4%, Rumania 54,3%, Greqia 40,6% dhe Shqipëria 27,9%. Shqipëria ka përqindjen më të ulët në të gjitha vendet.

I them këto, sepse e gjithë kjo panoramë me taksat më të ulëta nuk është për ata që fitojnë më shumë, sepse për ata, për oligarkët, që i quajnë këta, të cilët s'e dinë se çfarë do të thotë kjo fjalë, i kemi ndër më të lartat, pa diskutim i kemi më të lartat në Ballkanin Perëndimor, në 6 vendet joanëtare të Bashkimit Europian, ndërkohë që për të gjithë të tjerët kemi taksat më të ulëta. Kemi tatimin më të ulët mbi fitimin, kemi tatimin më të ulët mbi të ardhurat personale dhe kemi kontributet më të ulëta. Të gjitha këto janë para, të cilat nuk i merr buxheti, por qëndrojnë në arkën e familjeve, që do të thotë se edhe këto që shtojmë sot, edhe zerimin e inputeve bujqësore nuk e ka asnjë vend i rajonit. Po përmend rajonin, nuk po u hyjmë fare Bashkimit Europian dhe vendeve të tjera, që diskutojmë. Zero për inputet bujqësore, që do të thotë se buxheti i shtetit shkon te çdo njeri që punon tokën. Në fakt, ato para nuk merren më në buxhet, por u lihen atyre që punojnë tokën.

Unë nuk e di llogarinë e Erionit, 23 vjet, por di që ka 28 vjet, qëkur individit ka filluar të punojë tokën jashtë kooperativës, kostoja e inputeve ka qenë problemi i vet kryesor. Premtimi kryesor i të gjitha partive politike për fshatin, majtas dhe djathtas, në të gjitha fushatat, edhe yni në vitin 2013, ky ka qenë, por ne nuk e mbajtëm në mandatin e parë, sepse nuk i kishim mundësitë. Pse nuk i kishim mundësitë? Sepse lehtëso këtu, lehtëso aty, do të thotë hiq nga buxheti i shtetit dhe lëre te buxheti i familjeve. Kjo gjë nuk ishte e mundur të bëhej në mandatin e parë, por sot është e mundur dhe ne po e bëjmë këtë për të gjithë fermerët në të gjithë territorin e Shqipërisë.

Duke thënë këto, nuk them që i kemi zgjidhur të gjitha problemet, por atyre që thonë se ne jemi ata që kemi rritur taksat, unë u përgjigjem shumë thjesht: e kundërta është e vërtetë, ne kemi ulur taksat dhe kemi rritur bazën. Do të thotë që sot shumë më tepër

shqiptarë paguajnë taksat, shumë më tepër shqiptarë paguajnë kontributet, shumë më pak shqiptarë punojnë në të zezë dhe shumë më pak shqiptarë janë pa perspektivën e pensionit për shkak se ne kemi rritur formalizimin.

Ka akoma shumë hapësira. Të gjitha këtyre që diskutuam sot këtu, por edhe të tjerat, që nuk u diskutuan, por secili i do, është shumë kollaj, pa u menduar, por vetëm nga dëshira e mirë, t'u vëmë pikën jeshile për të thënë që jemi për më shumë, por çdo pikë jeshile këtu është një mund më vete dhe lidhet me të gjithë kontekstin e buxhetit dhe paketës fiskale.

Unë jam shumë krenar që ne sot miratojmë një buxhet dhe një paketë fiskale, e cila vitin e ardhshëm do të na japë qëndrueshmëri të rritjes së mëtejshme ekonomike, vepra në infrastrukturë me zhvillim të mëtejshëm, impakte të rëndësishme në të gjitha kategoritë, që nga rritja e pagave deri te zerimi i taksës mbi inputet bujqësore, si dhe mundësinë që të kemi mundësi të reja për buxhetin e vitit 2020.

Shumë faleminderit të gjithëve për kontributin tuaj!

Gramoz Ruçi – Faleminderit, zoti Kryeministër!

Vazhdojmë me amendamentet e reja, sipas radhës.

Hedhim në votim amendamentin e ri për nenin 5.

Votojmë me kartonë, ju lutem!

(Diskutim pa mikrofon nga salla)

Ju lutem, neni 5, neni 6, neni 7, neni 8 dhe neni 9 janë amendime të reja.

Pro? Kundër? Abstenim?

Nuk miratohet.

(Diskutim pa mikrofon nga salla)

Hedhim në votim amendamentin e ri për nenin 6.

Pro? Kundër? Abstenim?

Nuk miratohet.

Hedhim në votim amendamentin e ri për nenin 7.

Pro? Kundër? Abstenim?

Nuk miratohet.

Hedhim në votim amendamentin e ri për nenin 8.

Pro? Kundër? Abstenim?

Nuk miratohet.

Hedhim në votim amendamentin e ri për nenin 9.

Pro? Kundër? Abstenim?

Nuk miratohet.

Shtohet neni i ri me përmbajtje sipas raportit të komisionit përgjegjës.

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 5. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

E votojmë në tërësi.

Hapet votimi.

Me 75 vota pro, asnjë kundër, asnjë abstenim, miratohet.

Vazhdojmë me projektligjin “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

Fillojmë me nenet sipas variantit të propozuar, meqenëse komisioni nuk ka bërë vërejtje.

Neni 1. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 2. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 3. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 4. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 5. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 6. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 7. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 8. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 9. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 10. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 11. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 12. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 13. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 14. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 15. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 16. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 17. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 18. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 19. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

E votojmë në tërësi.

Hapet votimi.

Mbyllet votimi.

Me 76 vota pro, asnjë kundër, asnjë abstenim, miratohet.

Vazhdojmë me projektligjin “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë, të ndryshuar”.

Neni 1. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 2. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Shtohet neni i ri 2\1, sipas formulimit të komisionit përgjegjës.

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 3, me vërejtje të komisionit përgjegjës në pikën 3.

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 4. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 5. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Para se të kalojmë te neni 6, përsëri është depozituar një amendim nga zoti Braçe, i cili konsiston në shtim fjalësh në fund të nenit 6 të projektligjit.

Po, zoti Braçe.

Erion Braçe – Shqetësimi ka ardhur nga shoqatat e biznesit. Bëhet fjalë për pullën fiskale që vendoset në produktet e birrës.

Ministri i Financave dhe i Ekonomisë mendon se, edhe kur ndodhin dëmtime të pullave fiskale në lëvizje, duhet të ngarkohen subjektet që të paguajnë të gjithë dëmin, madje edhe me gjobën respektive.

Unë kam propozuar që edhe në lëvizje duhet adresuar shqetësimi si në prodhim, që ka firo, sepse në prodhim hidhen me ajër dhe mund të ndodhë që të mos ngjiten. Por mund të ndodhin edhe aksidente në lëvizje. Nëse kamioni rrëzohet në hyrje të territorit të Republikës së Shqipërisë dhe në qoftë se kjo vërtetohet nga organet ligjzbatuese, subjektet duhet të mos ngarkohen. Mund të ndodhë që kamioni të vidhet apo të digjet, kështu që do të ishte mirë që të parashikohet edhe në lëvizje.

Është reflektuar deri në procesin e prodhimit, por duhet të jetë edhe për procesin e lëvizjes, sepse është e padobishme që të ngarkohen subjektet kur një organ i certifikuar si policia, në një rast, apo prokuroria, në një rast tjetër, të verifikojë këtë lloj situatë.

Pra, vetëm në rastet kur kjo certifikohet nga institucionet ligjzbatuese të shteti, jo kur do subjekti.

Gramoz Ruçi – Zoti Ministër, keni ndonjë koment?

(Ministri flet nga vendi pa mikrofon.)

Si okej?!

Arben Ahmetaj – Shprehem dakord me amendamentin.

Gramoz Ruçi – Jeni dakord?

Atëherë, hedhim në votim amendamentin e bërë nga zoti Braçe.

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 6, me vërejtjet e komisionit përgjegjës për riformulim neni.

Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 7. Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 8, me vërejtjet e komisionit përgjegjës për zëvendësimin e shtojcës 1. Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 9. Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi.

Hapet votimi.

Mbyllet votimi.

Me 76 vota pro, asnjë kundër, asnjë abstenim, miratohet.

Kalojmë te projektligji “Për buxhetin e vitit 2019”.

Relatori ka ndonjë gjë për të paraqitur?

Anastas Angjeli – Komisioni për Ekonominë dhe Financat i shqyrtoi të gjitha sugjerimet dhe vërejtjet që kanë bërë komisionet gjatë diskutimit të tyre dhe në përfundim ka konsideruar disa ndryshime në projektin e paraqitur, të cilat konsistojnë në katër drejtime kryesore. Ato janë paraqitur në një tabelë

përmbledhëse dhe në mënyrë të hollësishme në relacionin që secili nga deputetët ka përpara.

Së pari, ndryshimet që bëhen në disa ministri për shpenzimet.

Së dyti, disa rialokime të brendshme, që vetë ministrët kanë bërë brendapërbrenda.

Së treti, transferata e pakushtëzuar në përgjithësi dhe në atë sektoriale për pushtetin vendor.

Së katërti, si rrjedhojë e tri ndryshimeve kryesore, që përmenda pak më sipër, duhet të gjenden edhe burimet e financimit të tyre.

Nga diskutimi që kemi zhvilluar në komision edhe me ministrin e Financave kemi rënë përgjithësisht dakord që ato të përballohen nga burimet e brendshme të vetë ministrive ose të rialokohen, por në të njëjtën kohë i kemi kërkuar ministrin, dhe besoj se ai do të shprehet për të gjetur mirëkuptimin, edhe një rritje të vogël të të ardhurave. Të gjitha ndryshimet kapin shumën prej 1 miliard e 381,5 milionë lekësh.

Pa marrë në konsideratë ato që do të sugjerojë ministri, ndryshimet që janë paraqitur në raport edhe në formën e amendamenteve, bashkë me zonjën Kushi, ia kemi paraqitur komisionit dhe këtu kanë ardhur si amendamente të komisioneve. Këto amendamente janë pikërisht në nenin 3 të projektligjit, i cili ndryshon si më poshtë: “Buxheti vendor për vitin 2019: të ardhurat bëhen 51,286 milionë lekë, nga të cilat transferata e përgjithshme e pakushtëzuar në vlerën 17,632 milionë lekë; transferata sektoriale e pakushtëzuar në vlerën 7443 milionë lekë, të ardhura të tjera në vlerën 26,211 milionë lekë, shpenzimet 51,286 milionë lekë”.

Neni 10, gjithashtu, ndryshon për shpenzimet e buxhetit sipas grupeve kryesore. Në të njëjtën kohë, për shkak se javën e kaluar parlamenti ka miratuar ligjin “Për Avokaturën e Shtetit”, i cili kalon nga Ministria e Drejtësisë në varësi të Kryeministrit, bëjmë shtojcën e amendamentit, ku në nenin 10 të projektligjit, në tabelën 1, ku referohet ky nen, bëhet ndryshimi si më poshtë: “Buxheti i miratuar për Avokaturën e Shtetit në Ministrinë e Drejtësisë të kalojë në grupin “87”, ku përfshihen institucionet në varësi të Kryeministrit”. Gjithashtu, ndryshon edhe fjalia e parë e nenit 11: “Numri i përgjithshëm i punonjësve në organikë bëhet 82 mijë e 120”.

Po ashtu, neni 13 ka të bëjë me fondin rezervë. Këtu dua të theksoj faktin se i është kushtuar një vëmendje e posaçme çështjes së reformës në drejtësi, duke miratuar njëherazi ndryshimin e propozuar për disa institucione në varësi të Ministrisë së Drejtësisë, ndërsa për organet e vetëgjyqësorisë dhe vazhdimin e reformës në drejtësi është parashikuar një fond rezervë, i cili do të akordohet për të gjitha institucionet që do të krijohen për reformën në drejtësi.

Në nenin 19, gjithashtu, në rreshtin e tretë duhet të ndryshojnë fjalët nga “viti 2018” të bëhet “viti 2019”.

Komisioni, duke parë problematikat që ka sot projekti i paraqitur, ka bërë edhe sugjerimet dhe rekomandimet përkatëse, që të fillojë menjëherë puna për zbatimin e buxhetit, në fillim të vitit, me qëllim që ekonomia shqiptare dhe qytetarët t’i ndiejnë këto efekte, në mënyrë të menjëhershme gjatë vitit të ardhshëm. Natyrisht, ne kemi bërë disa sugjerime, që lidhen me menaxhimin aktiv të borxhit publik, me qëllim që të vazhdojë iniciativa e marrë për ruajtjen e trajektore në ulje të borxhit publik.

Gjithashtu, meqenëse ka pasur një diskutim të gjerë për çështjen e projekteve të partneritetit publik-privat, janë pranuar sugjerimet për përmirësimin e projekteve dhe të cilësisë së këtyre projekteve. Nga ana tjetër, komisioni i fton të gjithë deputetët që janë këtu ta votojnë buxhetin me të gjitha ndryshimet.

Unë do të kërkoja që gjatë diskutimit nën nenin të merren parasysh ndryshimet dhe amendamentet në nenet përkatëse, si dhe të konsiderohen sugjerimet që do të bëjë ministri, sepse mund të ketë ndryshime edhe në nenin 1, edhe në nenin 2, nëse do të preken të ardhurat e buxhetit.

Faleminderit!

Gramoz Ruçi – Zoti Ministër, a keni sugjerime për ato që përcjell komisioni?

Arben Ahmetaj – Përtej asaj që kemi diskutuar me komisionin, unë dua të numëroj edhe një herë shtesat, për të cilat kemi rënë dakord gjatë paradites së sotme.

Së pari, shtohen të ardhurat me 200 milionë lekë për të korrigjuar rialokimin që i është bërë Ministrisë së Infrastrukturës.

Së dyti, në rialokimet e 1,36 miliardëve, për të cilat kemi rënë dakord, 100 milionë i shkojnë Ministrisë për Europën dhe Punët e Jashtme për

dy arsye kryesore: për atë që kërkoi Kryeministri në Pejë, pra për studimin dhe analizën e trajektores së bashkimit kombëtar deri në vitin 2025, siç u referua aty, si dhe për promovimin e Shqipërisë, që do ta vendosim në program, siç do ta përcaktojë ministri për Europën dhe Punët e Jashtme.

Fondi prej 2,6 miliardësh për mbështetjen e bujqësisë bëhet 600 milionë, ndërsa nga 2-miliardëshi, 1 miliard kalojnë te Ministria e Bujqësisë në fond, me kusht, i kërkuar me të drejtë nga ministri, që të alokohet nëpërmjet transfertës së kushtëzuar për bashkitë dhe investimeve të drejtpërdrejta të trupëzuara te “213-ta”, me vendim të Këshillit të Ministrave, pra t’i jepet e drejta Këshillit të Ministrave, ndërsa 1 miliard kalojnë te Fondi Shqiptar i Zhvillimit për programin “100 fshatrat”.

(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon)

Më falni?

(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon)

Po, edhe nga 2-milionëshi i sugjeruar i RTSH-së, siç e theksova, që e ka kërkuar komisioni, 100 milionë shkojnë te Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme, ndërsa 100-milionëshi tjetër kalon te rezerva e Këshillit të Ministrave, në funksion të logjikës që do të ketë qeveria.

Ministri për Diasporën ka një merak, por merakun e tij është konsideruar në tabelë me komisionin, prej 100 milionë lekësh brenda buxhetit të ministrisë, për të bërë atë që ka si mision.

Faleminderit!

Gramoz Ruçi – Atëherë, kalojmë në shqyrtimin nën për nen, me vërejtjet e Komisionit përgjegjës për Ekonominë dhe Financat, të reflektuara në raportin që i është paraqitur seancës plenare.

Neni 1. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 2. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 3. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 4. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 5. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 6. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 7. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 8. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 9. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Para se të kaloj te neni 10, përsëri kemi të depozituar një amendament nga deputeti Braçe lidhur me ndryshimet e tabelës 1 të projektligjit.

Po, zoti Braçe.

(Deputeti Braçe e fillon fjalën e tij nga vendi pa mikrofon.)

Erion Braçe – ...tërheq të gjitha.

Gramoz Ruçi – Atëherë, i tërhiqni.

Neni 10. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 11. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 12. Pro? Kundër? Një votë kundër.

Abstenim?

Miratohet.

(Diskutime në sallë.)

Urdhëroni, zoti Bashkim!

(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon)

Fjalën e ka deputeti Fino për shpjegim vote, dy minuta.

Urdhëroni!

Bashkim Fino – Faleminderit, zoti Kryetar!

Votova kundër nenit 12, sepse ky nen nuk përfaqëson hierarkinë e pagave në Republikën e Shqipërisë.

Kam bërë një diskutim në parim javën e kaluar për projektbuxhetin, por nuk dëgjova këtu nga përfaqësuesit e qeverisë dhe nga ministri i Financave në qoftë se do të ketë vërtet një lëvizje, një ngritje grupi ndërmënysh, për të rishikuar tabelën e pagave, sepse neni 12 tregon pikërisht hierarkinë e tyre. Në rastin konkret, ne miratojmë një pagë të Presidentit, ndërkohë që kemi një fashë me 800 veta, të cilët marrin dyfishin ose trefishin e pagës së Presidentit e të Kryeministrit.

Pak më parë dëgjova se dhatë përsëri fonde të tjera për Fondin Shqiptar të Zhvillimit. Vazhdoni, jepni fonde, ndërkohë që ai merr dyfishin e rrogës suaj, zoti Kryetar; dyfishin e rrogës së Kryeministrit e të Presidentit. Ky nen nuk përfaqëson, madje nuk ka për të përfaqësuar asnjëherë hierarkinë e pagave! Pra, ne po e

LEGJISLATURA IX - SEANCA E DITËS SË HËNË, 3 DHJETOR 2018

votojmë gabimisht një nen të tillë në buxhetin e shtetit.

Faleminderit!

Gramoz Ruçi – Edhe një herë, votojmë nenin 12. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 13. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 14. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 15. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 16. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 17. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 18. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 19. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 20. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 21. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 22. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 23. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë në votim në tërësi.

Hapet votimi me elektronikë.

Mbyllet votimi.

Me 76 vota pro, asnjë votë kundër, asnjë abstenim, miratohet projektbuxheti i vitit 2019.

(Duartrokitje nga salla)

Kalojmë te pika tjetër e rendit të ditës: “Për emërimin e anëtarit të bordit të komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë”. Kjo pikë shtyhet me kërkesë të kryetarit të grupit parlamentar.

Votimet e mbartura, siç e dini, janë dy: ai për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve dhe ai për ndryshimin e Kodit Rrugor, i cili, për shkak të kuorumit, nuk mund të kalojë në votim.

Faleminderit!

E konsideroj seancën të mbyllur këtu.

Seanca tjetër do të njoftohet.

(Seanca u mbyll në orën 13:50)

Kryetari i Kuvendit

Gramoz Ruçi

Sekretari për Procedurat dhe Votimin

Alket Hyseni

**Drejtori i Shërbimit të Botimeve
Parlamentare
Krenar Hajdëri**